



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me
profil “Infrastrukturë Transporti”**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

“Universiteti Europian i Tiranës ”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Igli KONDI

2. Dr. Egla LUCA

Maj/2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Për programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil "Infrastrukturë Transporti"**

Nr.		
1	Institucioni aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile, "Infrastrukturë Transporti", "Inxhinieri Strukturash", "Urbanistikë", "Administrim Territori", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektësh"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 630 datë 05.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhë Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (2020-2021)	3/7
18	Numri i studentëve: 2020-2021	13
19	Komente / të tjera:	Me shkresë Nr. 96 Prot., datë 20.04.2021, protokolluar në ASCAL me Nr. 19/5 Prot., datë 21/04/2021, IAL kërkon të akreditojë vetëm profilin "Infrastrukturë Transporti", me arsyen që profilet e tjera i ka joaktive.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 2

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile, "Infrastrukturë Transporti", "Inxhinieri Strukturash", "Urbanistikë", "Administrim Territori", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektësh" ofruar nga Universiteti European i Tiranës është pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Me shkresë Nr. 96 Prot., datë 20.04.2021, protokolluar në ASCAL me Nr. 19/5 Prot., datë 21/04/2021, IAL kërkon të akreditojë vetëm profilin "Infrastrukturë Transporti", me arsyen që profilet e tjera i ka joaktive. Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me qëllimin e objektivat e tij dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë dhe të tregut të punës

Universiteti European i Tiranës bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e nivelit të mësimdhënies duke rekrutuar staf akademik me ekspertizë profesionale në përputhje me programin e studimit.

UET ka garantuar për studentët një infrastrukturë bashkëkohore (auditorë, laboratorë, biblioteka, zyra etj) por jo të mjaftueshme për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profil, "Infrastrukturë Transporti". Struktura akademike dhe ndihmës akademike mbështet studentët dhe stafin akademik në përparimin e tyre. Kjo strukturë përmes akteve të brendshme rregullatore, garanton barazi dhe transparencë të proceseve brenda UET. Gjithashtu, studentët përfshihen në vendimmarrjen e UET në të gjitha nivelet dhe sistematikisht iu merret mendim në lidhje me cilësinë e mësimdhënies në UET.

Nga UET është në vëmendje mbështetja e studentëve edhe pas diplomimit, përmes rrjetit Alumni dhe bashkëpunimeve të shumta që ka me biznese e subjekte shtetërore e private të fushës së inxhinierisë dhe jo vetëm.

Në vija të përgjithshme grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi që programi i studimit ka nevojë të specializohet më shumë në drejtimin e përcaktuar, kërkohet vëmendje më e madhe në dokumentimin e rezultateve finale të studentëve dhe gjithashtu plotësimi i institucionit me laboratore të dedikuara për programin e studimit.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profil, "Infrastrukturë Transporti".

Bazuar ne VKM nr. 109 date 15.02.2017, me Urdhër Nr. 27, datës 15.03. 2022, ASCAL përcakton grupin e eksperteve për vlerësim të përbërë nga:

- Prof. Ass. Dr. Igli Kondi
- Dr. Egla Luça

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, MSc. Juna Mengri.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët përgatitën draft raportin dhe hartuan një gamë pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa pikave dhe problematikave të këtij raporti.

Gjatë vizitës së kryer në Universitetin Europian të Tiranës, në datat 10-11 Mars 2022, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Europian të Tiranës. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Më datë 11.05.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 87/57 Prot., datë 11.05.2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Deri me datë 23.05.2022 institucioni nuk ka derguar asnjë koment për draft raportin e vlerësimit të jashtëm, për këtë arsye draft raporti kthehet në raport përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI NDËRTIMI ME PROFIL “INFRASTRUKTURË TRANSPORTI”

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin bazë të dosjes së vetëvlerësimit si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon që programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtar, por është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të vëndit. Përmbajtja e programit është në përputhje të plotë me interesin kombëtar për të ndërtuar sa më shumë, sa më mirë e sa më lirë. Programi i studimit është konceptuar në përputhje me vizionin e Universitetit European të Tiranës, sipas të cilit arsimit të lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit sociale të një vendi. Ky program është menduar të jetë në harmoni me nevojat e tregut të punës të cilat përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit kanë evoluuar me mjaft shpejtësi, sikurse edhe me ndryshimet më të fundit teknologjike, duke synuar që t’u mundësohet Specialistëve të rinj bërja lehtësisht pjesë e këtij tregu.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” ka funksionuar si i tillë qysh nga viti akademik 2019 – 2020. Produkti i tij tashmë ka identitet të qartë dhe është integruar plotësisht në komunitetin e profesionistëve në fushën e ndërtimit. Si i tillë, referuar RVB dhe planeve strategjike të Universitetit, ai ka dëshmuar se është në vazhden e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e shkencore. <i>Referencë: URDHER Nr.630 datë 05.10.2018 Për Hapjen e Programit MSc ne INXHINIERI NDERTIMI</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Bazuar në mendimin e dekant lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti”, ofruar nga Departamenti i

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Inxhinierisë dhe Arkitekturës së Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës e Arkitekturës, është një program studimi bashkëkohor dhe në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin edukativ të Universitetit Europian të Tiranës, si përsa i takon ofertës akademike dhe kërkimit shkencor, ashtu edhe këndvështrimit ndaj sipërmarrjes, parë këto në funksion të shërbimit ndaj një ekonomie gjithnjë e më të përparuar.</p> <p><i>Referencë: Mendimi i Dekanit - MSh IND</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Bazuar në mendimin e dekanit, Ky program është menduar të jetë në harmoni me nevojat e tregut të punës të cilat përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit kanë evoluar me mjaft shpejtësi, sikurse edhe me ndryshimet më të fundit teknologjike, duke synuar që t’u mundësohet Specialistëve të rinj bërja lehtësisht pjesë e këtij tregu. Programi i studimit përveç paisjes të studentëve me njohuritë e nevojshme shkencore teorike që lidhen me fushën e tyre të studimit, formon edhe shprehitë e nevojshme tekniko-praktike, duke i aftësuar të përballen e zgjidhin problematika të ndryshme inxhinierike, në funksion të plotë të zhvillimit ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p> <p><i>Referencë: Mendimi i Dekanit - MSh IND</i></p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Në mënyrë që programi i studimit të krijoj baza për studime të thelluara në ciklin e tretë, rekomandohet që Institucioni të risë bashkëpunimet ndërkombëtare për fushën specifike, të ris kapacitetet fizike në drejtim të kërkimit të aplikuar shkencor (laboratore) dhe të detajoj më shumë kurrikulën e studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Notë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.2 Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Referuar planit strategjik të Universiteti Europian i Tiranës, për periudhën 2021 – 2025, lidhur me vizionin, prioritetet dhe objektivat strategjike, si edhe planin strategjik të njësisë bazë (DIA), GVJ konstaton që programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti”, ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit. Rekomandohet që në planin</p>

	<p>strategjik të institucionit në pikën 2 “Prioritetet e kërkimit shkencor”, të shtohen si fusha të kërkimit shkencor edhe inxhinieria e ndërtimit</p> <p><i>Referencë: Plani Strategjik UET 2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>GVJ konsultoi paraprakisht statutin e institucionit, rregulloren e tij, si edhe rregulloren e njësisë bazë për programin e studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Statuti është miratuar në vitin 2017, ndërsa programi i studimit është çelur në vitin akademik 2018 – 2019. Në statut nuk gjenden referenca specifike për programin e studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Në këtë këndvështrim rekomandojmë se statuti duhet rishikuar, saktësuar dhe plotësuar. Megjithatë programi i studimit është konceptuar në përputhje me frymën e statudit të institucionit, rregulloren e tij, si edhe rregulloren e njësisë bazë për këtë program studimi.</p> <p><i>Referencë: Statuti UET; Rregullore e UET;</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Ndërtimi” është program studimi që ofrohet për një kohëzgjatje normale 2 (tre) vite akademike, me gjithsej 120 ECTS.</p> <p>Ky program ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (DIA), pranë Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës (FIIA) dhe në përfundim studentit pajiset me diploma universitare “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Ndërtimi” (MSH Inxhinieri Ndërtimi, në profilin Infrastrukturë Transporti)</p> <p>Universiteti Europian i Tiranës, si një institucion privat i arsimit të lartë, është themeluar bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 636, datë 20.09.2006.</p> <p>Akreditimi i parë i institucional është përmbyllur me vendimin e bordit të akreditimit, Nr. 12, datë 07.04.2017, ku nuk përfshihet programi i studimit “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Ndërtimi” (MSH Inxhinieri Ndërtimi, në profilin Infrastrukturë Transporti)</p> <p>Ky program mbështetet në strategjinë institucionale të Universiteti Europian i Tiranës, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale dhe ato të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës si</p>

	dhe atyre të vetë Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës			
	Bazuar në strategjinë institucionale, GVJ konstaton që programi i studimit është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Ekonomia jonë po rritet dhe nevoja për inxhinierë ndërtimi me njohuri komplekse nga të gjitha fushat inxhinierike po prevalon me shpejtësi në kërkesat që ka tregu për Specialistë të rinj dhe veçanërisht spektri i gjerë i profilizimit të Inxhinieri Ndërtimit dhe drejtimi Infrastrukturë Transporti, garantojnë suksesin e këtij programi duke patur parasysh që të tilla drejtime parashikohet të marrin një zhvillim edhe më të madh në dekadën e tretë të këtij mijëvjeçari. Bazuar në mendimin e dekanit dhe në dokumentat plotësues të vënë në dispozicion nga Institucioni, GVJ konstaton që programi i studimit zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. <i>Referencë: Mendimi i Dekanit - MSh IND</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Referuar RVB-së si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që programi i studimit MSH Inxhinieri Ndërtimi, në profilin Infrastrukturë Transporti ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra në të gjitha lëndët e kurrikulës, duke formuar koncepte të qarta për dobinë e punës në ekip, duke rritur përgjegjësinë në vlerësimin e rezultateve të analizave laboratorike, duke njohur konkurrencën në tregun e punës, dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e produkteve të tyre. Referuar objektivave të përcaktuara si koncepte themelore në syllabysset e lëndëve, kostatohet që në këtë PS synohet t’u jepen studentëve dije, aftësi dhe kompetenca profesionale që karakterizojnë profilin e tij si:

	<ol style="list-style-type: none"> 1. aftësi për të zbatuar njohuri të matematikës, disiplinave shkencore dhe inxhinierike; 2. aftësi për të hartuar një sistem përbërës ose proces në përbushje të nevojave të dëshiruara; 3. aftësi për të funksionuar në ekipe multidisiplinare ; 4. aftësi për të identifikuar, formuluar dhe zgjidhur probleme inxhinierike; 5. përceptim të përgjegjësisë profesionale dhe etike; 6. aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive; 7. edukim për të kuptuar ndikimin e zgjidhjeve inxhinierike në një kontekst global dhe shoqëror; 8. njohje të nevojës dhe disponim të aftësisë për t'u përfshirë në mesimnxënie përgjatë gjithë jetës; 9. përditësim të njohurive bashkëkohore ; 10. aftësi për të përdorur teknikat dhe mjetet moderne inxhinierike të nevojshme për punën si inxhinierë etj.
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstatoi që Institucioni kryen studime për tregun e punës. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi (rreth 13) me kompani të ndryshme të fushës së ndërtimit e rrotull saj. Këto marrëveshje janë një bazë e mirë për punësimin e ardhshëm të të diplomuarve. Institucioni është pjesë gjithashtu e projektit 500+. Ky projekt përfshin 500 kompanitë më të mëdha në vend sipas klasifikimit zyrtar dhe është një projekt i gjerë bashkëpunimi 5 vjeçar në aspekte të ndryshme. Universiteti European i Tiranës si një universitet privat duke thelluar dhe materInstitucioni izuar kooperimin me biznesin dhe tregun e punës ofron për të gjitha këto kompani një gamë shërbimesh dhe procesesh që kanë të bëjnë me natyrën e institucionit, detyrat dhe qëllimet që kanë këto biznese. Projekti 500+ është materInstitucioni izim i një tendence bashkëkohore që e lidh gjithnjë e më ngushtë universitetin me tregun e punës dhe me biznesin si një nga funksionet themelore të universitetit në shoqëritë e sotme aq më tepër të universiteteve private.</p> <p>Bordi i tregut të punës është gjithashtu një mbështetje shumë e madhe e programit të studimit, jo vetëm për kryerjen e praktikave profesionale por gjithashtu edhe për konsulencat e vazhdueshme lidhur me përmirësimin e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit</p>	<p>Referuar objektiveve të përcaktuara si koncepte themelore në syllabysen e lëndëve, konstatohet që në këtë PS synohet t'u</p>

<p>të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>jepen studentëve dije, aftësi dhe kompetenca profesionale që karakterizojnë profilin e tij. Misioni i programit të studimit “Master i Shkencave” në "Inxhinieri Ndërtimi" është t'u japë studentëve një edukim cilësor, duke u bazuar kryesisht tek njohuritë praktike dhe teknike, nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, aftësimin për përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës, si dhe forcimit të partneriteteve me tregun e punës dhe partenireteteve ndërkombëtare,</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Falë marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit që Institucioni ka me institucione homologe në vende të huaja, programi i studimit është në linjë me programe të ngjashme në vende të tjera. Gjithashtu ky program është mjaft i ngjashëm edhe me programe studimi brenda vëndit, gjë e cila lehtëson procesin e transferimit dhe njohjes së kurrikulës.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe direktivat e BE, ndjek dhe zbaton kartën e Bologni-as. Programi në fjalë është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore të tij, si dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit Europian të Tiranës.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit ka në focus të tij praktikën profesionale. Në dokumentat e vënë në dispozicion nga Institucioni jepen kompanitë specifike ku studentët kanë kryer praktikën e tyre (13 kompani). Praktika profesionale ka 12 ECTS</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit të institucionit.</p>	<p>Aktualisht të gjitha lëndët dhe modulet zhvillohen në gjuhën Shqipe bazuar në aktin e licencimit të programit të studimit. Rekomandohet që të rriten bashkëpunimet me institucione homologe në vende të tjera që kanë programe të ngjashme studimi, në mënyrë që programi i studimit të përfitoj nga ndërkombëtarizimi dhe të rritet mobiliteti i stafit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, Institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Institucioni, përveç syllabuseve, përgatit dokumentacion vetëm në gjuhën shqipe. Syllabuset gjenden në dy gjuhë, në atë shqipe dhe gjuhën angleze, në version të shkurtuar.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua gjetjeve në RVB si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik, me një përvojë të përshtatshme në disiplina specifike të inxhinierisë së ndërtimit.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Në strukturën përbërëse të tij përfshihet edhe Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (përgjegjës për programin e studimit).</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang fakulteti (26 pedagogë) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5 Profesorë Dr. - 2 Profesorë të Asociuar Dr. - 7 Doktorë/PhD - 12 MSc. <p>Personeli Akademik me Kontratë (PAK) në rang fakulteti (38 pedagogë) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 Profesorë Dr. - 8 Profesorë të Asociuar Dr. - 16 Doktorë/PhD - 11 MSc. <p>Personeli Akademik Efektiv në rang departamenti, përgjegjës për programin e studimit (9 pedagogë), përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 Profesorë Dr. - 1 Profesor i Asoc. Dr. - 3 Doktorë - 2 MSc

	<p>Personeli Akademik me Kontratë në rang departamenti, përgjegjës për programin e studimit (25 pedagogë), përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Profesorë Dr. - 6 Profesor i Asoc. Dr. - 11 Doktorë - 6 MSc <p>Institucioni është me përvojë në ofrimin e programeve të studimit në fushat humane, në profilin e Inxhnierisë së Ndërtimit, <i>Universiteti Europian i Tiranës ka nevojë të kristalizohet dhe të risë kapacitetet njerëzore dhe fizike të dedikuara për programin e studimit MSh në Inxhnieri Ndërtimi.</i></p> <p><i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm; Tabelat përmbledhëse.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MSh në Inxhnieri Ndërtimi, profile Infrastrukturë Transporti është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, si edhe të Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës.</p> <p>Në nivel programi studimi janë të dhënat e mëposhtme.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2019-2020 programi i studimit ka patur 4 staf akademik Efektiv me tituj dhe grada dhe 4 staf me kontratë me tituj dhe grada, përveç një stafi i cili ka titullin “MSc”.</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021, vihet re një ulje e stafit efektiv. Më saktësisht janë 3 profesor me tituj dhe grada si staf akademik efektiv dhe 7 profesor me kontratë. Edhe këtë vit akademik një prej antarëve të stafit akademik me kontratë nuk ka gradën e duhur për të qënë titular lënde sepse ka titullin MSc (edhe pse është në process të fitimit të titullit doctor).</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri GVJ iu referua gjetjes në RVB ku shkruhet se programi i studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil Infrastrukturë Transporti ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, i cili, sipas ligjit të arsimit të lartë, është njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Departamenti</p>

<p>sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>ofron programe studimi në nivelin Bachelor dhe Master. Departamenti mirëpret studentët që dëshirojnë të studiojnë për programet e studimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit të arsimit të lartë në Shqipëri, si dhe me procesin Evropian të Bolonjës dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil Infrastrukturë Transporti është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Në planin strategjik të këtij departamenti GVJ gjeti objektivat dhe synimet e departamentit lidhur me zhvillimin e programit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil Infrastrukturë Transporti.</p> <p><i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB, si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që Universiteti Evropian i Tiranës ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit, duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore (fakultetet). Në rastin konkret GVJ u informua për një sërë aktivitete me pjesëmarrje të studentëve e pedagogëve të tri njësive bazë të fakultetit. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim</p>

	<p>është i qëndrueshëm dhe efikas. Bashkëpunimi nuk është vetëm në nivel fakulteti por edhe në nivel universiteti, pasi disa nga lëndët janë jepen nga staf i angazhuar në fakultete dhe programe të tjera studimi. Rekomandohet që për stafin i cili nuk është pjesë e FIHA, të ketë dokumentacion të shkruar që lejon stafin e një fakulteti të kryej mësim në një fakultet tjetër brenda institucionit.</p> <p><i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm;</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Përveç gjetjeve në DVV, lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendës e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e zyrës së projekteve e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet, duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme.</p> <p>Për hartimin dhe mbikqyrjen e programeve të studimit institucioni, nxit bashkëpunimin midis personelit brenda Universiteti European i Tiranës nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar një mënyre të garantuar për të pasur marrëdhënie eficiente bashkëpunimi.</p> <p>Po ashtu, Universiteti European i Tiranës ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj për realizimin e objektivave të programeve të studimeve duke siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron, për të organizuar trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit; dhe së fundmi duke raportuar analitikisht përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> <p>Në kuadër të projekteve Erasmus+, më specifikisht projekti Engine, Universiteti European i Tiranës do të ngre laboratorin e testimit të materialeve të ndërtimit. Gjatë vizitës në institucion na u vu në dispozicion lista e pajisjeve që do të blihen. Gjithashtu Departamenti i Inxhnierisë dhe Arkitekturës duke përfshirë programet e shkëmbimit (Erasmus: përfshirja në projekte të përbashkëta kërkimore – studimore me analoge</p>

	<p>europiane në fushën e Arkitekturës e Inxhinierisë, Aquila Italy, Budapest Hungary, Bolonja Italy, Lituani). Pjesë e shkëmbimeve, si rezultat i marrëveshjeve janë edhe pedagogët tanë të cilët japin mësim në Universitetet e tjera. Kështu, deri më sot, Prof.Asoc.Dr. Arben Dushi, ishte në Obuda University (Budapest, Hungary) ku dha mësim për disa ditë, për studentët e Inxhinierisë.</p> <p>Gjatë viteve të operimit të programit të studimit nuk ka patur mobilitet të studentëve. Rekomandohet që Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhnierisë, më specifikisht programi i studimit MSH në Inxhnieri Ndërtimi, të përfshihet më shumë në planin e projekteve ndërkombëtare të Institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, Institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Programet e këtij departamenti janë hapur me urdhra të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 544 dhe 630 / 2018 (BA / MSH: Inxhinieri Ndërtimi), dhe viti akademik 2020 - 2021 përkon me diplomimin e brezit të parë të studentëve nga programet e ofruara nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Departamenti, për rishikimin e kurrikulave dhe kërkesave të tregut të punës departamenti ka kontaktuar me një sërë kompanish me të cilat ka krijuar marrëveshje në lidhje me këto tematika. Me rishikimin e kurrikulave, mbështetur në programet ndërkombëtare, është duke u marë Dr. Ing. Maksim Çipi dhe Prof. Dr. Angjelin Shtjefni, në bashkëpunim me Zyrën e Projekteve.</p> <p>Universiteti Europian i Tiranës ka prezantuar Bordin e ri të Besimit, i cili përbëhet nga pesë anëtarë, profesionistë dhe personalitete të spikatura në fushat përkatëse, të cilat u përshtaten të pesta fakulteteve të Universiteti Europian i Tiranës.</p> <p>Ky bord përbëhet nga pesë anëtarë dhe ka si objektivi të tij të qenët një strukturë aktive, me një rol mbikëqyrës, ku secili prej anëtarëve të tij do të jetë një “Dekan” nderi për fakultetin përkatës.</p> <p>Për studentët ciklit Master, praktikat janë zhvilluar në institucionet ku ata janë të punësuar. Të gjithë studentët e ciklit mater kanë qenë të punësuar. Në mbrojtjen e praktikave profesionale studentët kanë dorëzuar formularin e aplikimit për praktikën profesionale, formularin e vetëvlerësimit, CV, letër motivimi, formularin e vlerësimit nga pedagogu dhe nga</p>

	mbikëqyrësi i praktikës dhe raportin e praktikës. Secili student ka vendosur vetë kontaktet me kompanitë ku ka punuar. Nga takimet në Institucioni me përgjegjësen e departamentit u tha që nëse student nuk është në gjendje të gjej kompani për kryerjen e praktikës, atëherë departamenti kontakton me bordin e besimit dhe përdor një nga kompanitë që ka marrëveshje bashkëpunimi.			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	Bazuar në DVV, GVJ mësoi se bashkëpunimi me punëdhënësit, për kryerjen e praktikave profesionale është vendosur përmes marrëveshjeve të shkruara, por jo detyruese. Çdo vit nga Departamenti i Inxhnierisë dhe Arkitekturës hartohet një raport vjetor në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat, përfshirë këtu edhe ato në fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raporti vjetor përmbledh dhe analizon përfitimet e këtyre marrëveshjeve. <i>Referencë: Dosja e vetëvlerësimit</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Bazuar në DVV dhe në bisedat e kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se Universiteti Europian i Tiranës organizon trainime profesionale për studentët, kryesisht në formën e leksioneve të hapura. <i>Referencë: Dosja e vetëvlerësimit</i>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Bazuar në DVV, GVJ mësoi se bashkëpunimi me punëdhënësit, për kryerjen e praktikave profesionale është vendosur përmes marrëveshjeve të shkruara, por jo detyruese. Çdo vit nga Departamenti i Inxhnierisë dhe Arkitekturës hartohet një raport vjetor në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat, përfshirë këtu edhe ato në fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raporti vjetor përmbledh dhe analizon përfitimet e këtyre marrëveshjeve. <i>Referencë: Dosja e vetëvlerësimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Departamenti i Inxhnierisë dhe Arkitekturës u ofron stafit akademik mundësinë për të publikuar në revistat shkencore NODUS dhe për të referuar në aktivitetin e organizuar nga Institucioni “Ditët e studimeve Shqiptare”. Universiteti Europian i Tiranës stimulon stafin të publikojë në revista me faktor impakti si Thomson, Reuters, etc. Për këtë Institucioni ka ndërtuar një skemë financimi të kërkimit shkencor për stafin i cili publikon në revistat e sipërpërmendura.								
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni ka hartuar strategjinë e kërkimit shkencor, në të cilin përcaktohen objektivat dhe instrumentat që Universiteti Europian i Tiranës ka në raport me kërkimin shkencor. Institucioni ka edhe pozicionin e Zv. Rektorit për kërkimin shkencor. <i>Referencë: Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020; Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025</i>								
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Gjatë vlerësimit të performancës së secilit staf akademik, ose ndryshe folloë up, vlerësohet qartazi edhe aktiviteti kërkimor shkencor i secilit personel akademik.								
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pyeti lidhur me mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe softëare të ndryshëm kundër plagjiaturës. Na u tha që një softëare i till nuk përdoret.								
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Institucioni organizon cdo vit “Ditët e studimeve Shqiptare” dhe aty fton dhe nxit studentët dhe kërkuesit e rinjë të marrin pjesë dhe të publikojnë në këtë event.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI
NDËRTIMI ME PROFIL “INFRASTRUKTURË TRANSPORTI”**

Standardi II.1

Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” është i strukturuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra të rregullt.</p> <p>Zhvillohen gjithsej 16 lëndë dhe 1 praktikë profesionale dhe 1 punim diplome. Në total 18 lende të ndara sipas 2 viteve akademike (10 lëndë në vitin e parë; 6 lëndë në vitin e dytë; praktika profesionale dhe punimi i diplomës në vitin e dytë). Në 18 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës, si edhe praktika profesionale. Lëndë të detyrueshme janë 18. Lëndë me zgjedhje janë 0. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Cdo vit akademik ka mesatarisht 60ECTS (61 ECTS Viti i parë dhe 59 Viti i dytë).</p> <p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Gjithashtu, paralel me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), Institucioni përdor edhe kreditet amerikane, dhe sistemin e vlerësimit GPA amerikan. Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra,</p>

	<p>veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Rekomandohet shpërndarja uniforme e krediteve ne dy vitet akademike.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e Specialitetesh.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” ka nevojë të plotësohet me lëndë të një karakteri më gjithëpërfshirës në mënyrë që të jetë një program më atraktiv për tregun e punës. Rekomandohet shtimi i lëndëve të menaxhimit të ndërtimit dhe i lëndëve të dedikuara për testimin e materialeve ndërtimore në mënyrë që studentët të jenë më atraktiv për tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Lëndët e parashikuara të zhvillohen në programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me profil Infrastrukturë Transporti janë të larmishme. Fillohet në vit të parë me Metoda Kërkimi të Avancuara, Aplikime të avancuara të fizikës teknike, Teoria e avancuar e strukturave 1, Konstruksione Special e Beton Arme, Ura dhe Tunele, Teoria e avancuar e strukturave 2, Mekanika e Dherave dhe Shkembit, Konstruksione Metalike + Beton Arme, Dinamika e strukturave dhe inxhinieria sizmike, Dyshemetë rrugore, hekurudhore dhe aeroportuale. Në vit të dytë vijohet me Mekanika e Themeleve, Gjeologjia e Aplikuar, Projektim Urbanistik 1 Topografi dhe Hartografi Punimi i diplomës, Restaurimi dhe perforcimi i strukturave, Praktike profesionale, Punimi i diplomës.</p> <p>Në total syllabuset e hartuara synojnë të rrisin aftësinë e studentëve të kuptojnë parimet e inxhinierisë gjeoteknike (sjellja e dherave), inxhinierisë së strukturave (analiza dhe projektimi i strukturave prej betoni të armuar dhe strukturat e çelikut, beton Special, restaurim dhe përforcim i strukturave), inxhinierisë së transportit (dyshemetë rrugore, urat dhe tunelet), etj.</p> <p><i>Programi ofron njohuri të avancuara, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së inxhinierisë së ndërtimit, por pak janë lëndët që ofrojnë dije të thelluara të profilit specifik. Rekomandohet shtimi i lëndëve të profilit dhe reduktimi i orëve dhe krediteve të lëndëve si Aplikime të avancuara të fizikës teknike, konstruksione</i></p>



	<i>Special e beton arme, restaurim dhe përforcim i strukturave. Gjithashtu rekomandohet shtimi i lëndëve zgjedhore ne kurrikulën e programit. Disa prej lëndëve të sipërpërmendura mund të jenë pjesë e grup lëndëve me zgjedhje.</i>															
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të Specializuar studimi ose profesionale.	Duke iu referuar kurrikulës së PS vihet re që lëndët që ofrohen duhet të jenë më specifike dhe më të dedikuara për profilin e Infrastrukturës së transportit. Edhe pse titujt e lëndëve janë mjaftë gjithëpërfshirëse, në sylabusin e tyre vërehet që i kushtohet pak vëmendje zgjidhjes së problemeve specifike në fushën e infrastrukturës së transportit. Duke parë ndodhitë e viteve të fundit, si shëmbja e shumë urave, rekomandohet shtimi i analizës dhe zgjidhjeve të mundshme të këtyre problematikave. Një lëndë që mund ta plotësonte kurrikulën është edhe Dinamika e dherave duke qënë se disa prej problemeve në urat e sipërpërmendura ka ardhur si rezultat i cedimit të dherave nga tërmeti në këmbët e urave.															
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë Nr. 80/2015. Programi ofrohet me 120 ECTS me kohëzgjatje 2 vjecare. Edhe rregullorja e studimit bazohet në ligjin e sipërpërmendur.															
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Lëndët dhe përmbajtja e kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive A-E me pëeshën specifike të përcakuar në VKM 41 24.01.2018. <table border="0"> <tr> <td>A - Lëndë Bazë</td> <td>12 ECTS</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>B- Lëndë Karakterizuese</td> <td>60 ECTS</td> <td>50%</td> </tr> <tr> <td>C -Lëndë Ndërdisciplinore / Integruese</td> <td>18 ECTS</td> <td>15%</td> </tr> <tr> <td>D- Lëndë Plotësuese</td> <td>12 ECTS</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>E - Detyrime Përmbyllëse</td> <td>18 ECTS</td> <td>15%</td> </tr> </table> <p>Vërehet që kurrikula e programit të studimit nuk ka lëndë me zgjedhje. Rekomandohet shtimi i të paktën 2 lëndëve zgjedhore. Në kurrikul ekziston një lëndë nën kategorinë D “Honors Course”, rekomandohet që kësaj lënde ti jepet karrakter zgjedhor dhe gjithashtu lënda në vetëvete të specifikohet. Institucioni ka filozofinë e vetë të ndarjes së lëndëve në Lëndë të Tipologjisë 1 dhe lëndë të tipologjisë 2. Diferenca qëndron në mënyrën e vlerësimit dhe mënyrën e zhvillimit të lëndëve. Duke parë historikun e institucionit, GVJ rekomandon që ose duhet krijuar një kategori e tretë për lëndët e inxhnierisë së ndërtimit, ose të mos specifikohen fare. Duke i lënë më</p>	A - Lëndë Bazë	12 ECTS	10%	B- Lëndë Karakterizuese	60 ECTS	50%	C -Lëndë Ndërdisciplinore / Integruese	18 ECTS	15%	D- Lëndë Plotësuese	12 ECTS	10%	E - Detyrime Përmbyllëse	18 ECTS	15%
A - Lëndë Bazë	12 ECTS	10%														
B- Lëndë Karakterizuese	60 ECTS	50%														
C -Lëndë Ndërdisciplinore / Integruese	18 ECTS	15%														
D- Lëndë Plotësuese	12 ECTS	10%														
E - Detyrime Përmbyllëse	18 ECTS	15%														

	<i>shumë liri profesorit në mënyrën e organizimit të lëndës, programi i studimit dhe studentët do të përfitojnë më shumë.</i>			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Në programit ne studimit, punimi i diplomës ndodhet në kategorinë E “DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 10%-15% / 12-18 ECTS” dhe punimi ka 18 ECTS. Nga biseda me përgjegjësën e departamentit dhe me studentët, na u tha që kjo lëndë nuk është vetëm punë e pavarur, por ka një sasi orësh në auditor ku studentët ndjekin leksione mbi mënyrën e shkrimit të një teme diplome. <i>Rekomandohet që ky detaj të shtohet në kurrikul pasi orën e leksionit nuk reflektohen në programin mësimor. Gjithashtu ka mospërputhje ndërmjet tabelës 9 (Ndarja e lëndëve në tipe veprimtarie) dhe tabelës 10 (plani mësimor i programit MSH në Inxhinieri Ndërtimi) ku punimit të diplomës i janë dhënë vetëm 12 ECTS dhe jo 18 sic deklarohehet më sipër.</i> <i>Referencë: Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MSH Inxhinieri Ndërtimi</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (DIA) është pjesë përbërëse e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Institucioni, rezultojnë se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	FIIA i cili është përgjës për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore sipas përcaktimit të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 për të ofruar programin në fjalë. Fakulteti është i përbërë nga 2 departamente dhe një qendër për zhvillimin e teknologjisë së informacionit. Për vitin akademik 2020-2021 DIA ka 9 PAE dhe 25 PAK (tabela 1 Anexi tabelat përmbledhëse) Për vitin akademik 2021-2022 DIA ka 10 PAE dhe 11 PAK, semestri 1. (tabela 1 Anexi tabelat përmbledhëse)

	<i>Referencë: Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MSH Inxhinieri Ndërtimi</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë-përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	<p>Për vitin akademik 2018-2019 në Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës kanë qenë të angazhuar: Personel Akademik me kohë të plotë 7 1 Profesor 1 Prof. As. Dr. 1 Dr. 2 Msc Personel Akademik me kohë të pjesshme 2 2 Dr. Raporti PAE/ PAK -----7/2</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 në Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës kanë qenë të angazhuar: Personel Akademik me kohë të plotë 8 3 Profesor 1 Prof. As. Dr. 2 Dr. 2 Msc Personel Akademik me kohë të pjesshme 16 2 Profesor 3 Prof. As. Dr. 6 Dr. 5 Msc Raporti PAE/ PAK -----8/16</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 në Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës kanë qenë të angazhuar: Personel Akademik me kohë të plotë 9 3 Profesor 1 Prof. As. Dr. 3 Dr. 2 Msc Personel Akademik me kohë të pjesshme 25 1 Akademik Asoc. 1 Profesor 6 Prof. As. Dr. 11 Dr. 6 Msc Raporti PAE/ PAK -----9/25</p>

	<p>Për vitin akademik 2021-2022 (semstri i parë) në Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës kanë qenë të angazhuar:</p> <p>Personel Akademik me kohë të plotë 10 3 Profesor 1 Prof. As. Dr. 4 Dr. 2 Msc</p> <p>Personel Akademik me kohë të pjesshme 16 1 Akademik Asoc. 1 Profesor 2 Prof. As. Dr. 4 Dr. 8 Msc</p> <p>Raporti PAE/ PAK -----10/16</p> <p>Institucioni është i vërtëdijshëm për raportin jashtë standardi ndërmjet stafit të brëndshëm dhe atij të ftuar.</p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e menjëhershëm të stafit me kohë të plotë dhe pozicionimin e stafit pa grada dhe tituj në rolin e asistentit për lëndët specifike.</i></p> <p><i>Në RVB citohet që edhe pse në rolin e stafit të jashtëm, personeli i ftuar të kontribuoj në program ka eksperiencën e duhur të mbulojë lëndët respective. Gjatë vizitës në Institucioni u kërkua që për secilin staf akademik të jepej lënda që ai/ajo mbulon së bashku me publikimet përkatëse të gjithë secilit. Ky document nuk na u vu në dispozicion nga Institucioni.</i></p> <p><i>Referencë: Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MSH Inxhinieri Ndërtimi</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FIIA i cili është përgjës për programin e studimit përmush detyrimet ligjore sipas përcaktimit të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 për të ofruar programin në fjalë. Fakulteti është i përbërë nga 2 departamente dhe një qendër për zhvillimin e teknologjisë së informacionit. DIA / për vitin 2021-2022 (semstri 1) ka 26 antarë të personelit akademik, nga ku vetëm 10 janë staf i brëndshëm, nga të cilët 8 janë me grada dhe tituj, dhe 16 janë staf PAK (Vërehet mospërputhje ndërmjet tabelës 1</p>

	<p>dhe tabelës 2, në tabelën 1 deklarohen 19 staf i DIA, në tabelën 2 deklarohen 26 staf i DIA)</p> <p>DIA për vitin 2020-2021 ka 34 antarë të personelit akademik, nga ku vetëm 9 janë staf i brendshëm, nga të cilët 7 janë me grada dhe tituj, dhe 25 janë staf PAK. (Tabela 1 dhe tabela 2)</p> <p>Programi i Studimit, për vitin 2019-2020 ka 24 antarë të personelit akademik, nga ku vetëm 8 janë staf i brendshëm, nga të cilët 6 janë me grada dhe tituj, dhe 16 janë staf PAK.</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës përbëhet nga 2 (dy) departamente dhe 1 (një) njësi kërkimore shkencore, të cilët funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Teknologjisë dhe Informatikës; 2. Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës. 3. Qendra për zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionin. <p>Nga sa më sipër njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Bazuar në tabelën 1 dhe 2 (Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë, gradat shkencore/titujt akademikë; Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës përgjegjës për programin e ciklit të parë MSH në "Inxhinieri Ndërtimi")</p> <p><i>Referencë: Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MSH Inxhinieri Ndërtimi</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Njësia bazë nuk ka personel akademik ndihmës për ndjekjen e praktikave profesionale, por angazhohet stafi akademik së në bashkëpunim me bordin e besimit për të ndjekur praktikat profesionale të studentëve. Koordinatori i programit është përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit ka një koordinitor të caktuar me vendim Nr. 36 datë 14.04.2021. Koordinatori ndjek në vazhdimësi ecurinë e zhvillimit të programit dhe raporton tek drejtuesi i DIA. Detyra e tij është të</p>

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	shqyrtoj edhe silabuset, miratimi i temave të diplomave, ndjek ecurinë e praktikave.			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Koordinatori ndjek në vazhdimësi ecurinë e zhvillimit të programit dhe raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek drejtuesi i DIA. Detyra e tij është të shqyrtoj edhe silabuset, miratimi i temave të diplomave, ndjek ecurinë e praktikave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës zotëron informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti”. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, plani strategjik i universitetit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë.</p> <p>Departamenti dhe cdo anëtar i personelit akademik/administrative ka akses të plotë tek dokumentat e sipërpërmendura. Cdo fillim semestri studentëve u vihen në dispozicion sylabuset dhe materialet e leximit.</p>
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” është i strukturuar në 2 vite shkollorë dhe 4 semestra. Zhvillohen</p>

gjithsej 16 lëndë (90 ECTS) dhe 30 kredite vijnë nga praktika profesionale dhe teza e diplomës, të ndara sipas 2 viteve shkollorë (10 lëndë në vitin e parë; 8 lëndë në vitin e dytë). Në 18 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës, si edhe praktika. Lëndë të detyrueshme janë 16. Lëndë me zgjedhje nuk janë parashikuar. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).

Në kategorinë A bëjnë pjesë 2 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 10 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 1 lëndë, në kategorinë E bëjnë pjesë 1 lëndë. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:

A - Lëndë Bazë	12 ECTS	10%
B- Lëndë Karakterizuese	60 ECTS	50%
C -Lëndë Ndërdisciplinore / Integruese	18 ECTS	15%
D- Lëndë Plotësuese	12 ECTS	10%
E - Detyrime Përmbyllëse	18 ECTS	15%

Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. ***GVJ rekomandon të rishikohet shpërndarja e lëndëve në tipe veprimtarie. Në dokument e vënë në dispozicion nga Institucioni "Kurrikula e programit MSH", në kategorinë C, thuhet që janë 18 ECTS, por ndërkohë në këtë kategori është edhe lënda Honors Course me 6 ECTS, lëndë e cila nuk është e pasqyruar në asnjë vënd në plan programin mësimor. Në kuadër të përmirësimit të kurrikulës, GVJ rekomandon shtimin e krediteve të lëndëve të profilit si Ura dhe Tunele, DysHEME rrugore, hekurudhore dhe aeroportuale, dhe ulje e krediteve në lëndë të tjera jo thelbësore për Specialitetin si Aplikime të avancuara të fizikës teknike. Ashtu sic e kemi rekomanduar edhe më sipër, programi ka nevojë të rishikohet në raport me lëndët që oforn, dhe se duhen shtuar lëndët e specialitetit. Gjithashtu shtimi i lëndëve lidhur me softëare llogaritës do ti jepte programit të studimit një "boost". Vihet re gjithashtu mungesa e lëndëve lidhur me materiale ndërtimi dhe***

	menaxhim ndërtimi. GVJ konstaton që këto lëndë janë thelbësore për një student MSH.
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” është i strukturuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra. Zhvillohen gjithsej 16 lëndë (90 ECTS) dhe 30 kredite vijnë nga praktika profesionale dhe teza e diplomës, të ndara sipas 2 viteve akademike (10 lëndë në vitin e parë; 8 lëndë në vitin e dytë). Në 18 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës, si edhe praktika. Lëndë të detyrueshme janë 16. Lëndë me zgjedhje nuk janë parashikuar. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).
Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në rregulloren e PS. Mbështetet në parimin e kontrollit të vazhduar. Mënyra e vlerësimit varet nga tipologjia e lëndës dhe është e përcaktuar edhe në sylabus.
Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. Institucioni, nëpërmjet zyrës së pranimeve, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranim, transfertë dhe njehësim studimesh. Të gjitha informacionet janë bërë publike dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të universitetit, si dhe janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit. Në rregulloren e PS parashikohet në pikën 2 “Pranimi në programin e studimit” mënyra dhe kriteret që duhet të plotësojë cdo student. Edhe transferimi i studentëve është i rregulluar në dokumentin D.II “mbi transferimin dhe njohjen e krediteve”. Po ashtu këto informacione gjenden edhe në rregulloren e Programit të studimit MSH. Nga vizita në Institucioni dhe nga takimi me studentët, u konstatua që në

	<p><i>këtë program studimi janë regjistruar student që vijnë nga fusha shumë të ndryshme nga ajo e inxhnierisë së ndërtimit. Si përshëmbull Ekonomik. Gjithashtu pjesa më e madhe e studentëve të regjistruar në master nuk vinin nga një program Bachelor në Inxhnieri ndërtimi. Edhe pse shumë prej tyre vinin nga programe inxhnierike, si gjeologji, inxhnieri tekstile, etj, këta student nuk kanë marrë dijet e nevojshme për tu thelluar më tej në një program master. Përshëmbull studentët që vinin nga programet e sipërpërmenduar nuk kanë zhvilluar asnjë orë mësimi konstruksione betonarme në bachelor, por ndërkohë në programin e MSH ka lëndë Beton Arme i Avancuar, ose Special, ose lëndët e specialitetit. Studentët në fjalë nuk kanë zhvilluar asnjë orë në bachelor mbi infrastrukturën e transportit, dhe përballen në master në llogaritje të avancuara. Për studentin e regjistruar me bachelor në Ekonomi, situata është akoma më e rëndë pasi edhe baza matematike e zhvilluar është krejt e ndryshme nga ajo që ofrohet në programet inxhnierike.</i></p> <p><i>GVJ këtë fakt e konsideron të një rëndësie të vecantë në zhvillimin e programit të studimit. Rekomandohet që studentët që regjistrohen në master, nëse nuk vijnë me një bachelor të fushave të inxhnierisë së ndërtimit, të ndjekin lëndë në bachelor përpara se të hyjnë dhe të ndjekin lëndë në master. Nëse nuk kryehet ky proces, kjo kthehet në pengesë edhe për profesorin i cili duhet të shpjegoj bazat (të cilat zhvillohen në BSc) në mënyrë që nëse del koha të shpjegoj teorinë e avancuara. Zyra e studentëve apo e këshillimit duhet të punojë në këtë drejtim që ti orientoj studentët të thellohen në studime master në fusha të ngjashme me ato të bachelor.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë. Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënies të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.</p>

<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Universiteti përdor të dhëna cilësore dhe sasore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara si Bordi i Tregut të Punës, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga universiteti.</p> <p>Para fillimit të çdo viti akademik zhvillohen takime pune për të parë nevojën e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit. Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga departamenti përkatës. Vendimet për rishikimin e kurrikulave merren mbi bazën e propozimeve të njëjësive bazë. Pas kësaj vendimet e njëjësive bazë kalojnë për miratim në këshillin e fakultetit dhe në senat.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” është i strukturuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra (Referuar pika 3.2.1 Regullore Mësimore MSH). Zhvillohen gjithsej 16 lëndë (90 ECTS) dhe 30 kredite vijnë nga praktika profesionale dhe teza e diplomës, të ndara sipas 2 viteve shkollorë (10 lëndë në vitin e parë; 8 lëndë në vitin e dytë). Në 18 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës, si edhe praktika. Lëndë të detyrueshme janë 16. Lëndë me zgjedhje nuk janë parashikuar. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Referencë: Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Ndërtimi; Plani mësimor i programit - MSH Inxhinieri Ndërtimi</i></p>

<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. Fillohet me në vit të parë Metoda Kërkimi të Avancuara, Aplikime të avancuara të fizikës teknike, Teoria e avancuar e strukturave 1, Konstruksione Special e Beton Arme, Ura dhe Tunele, Teoria e avancuar e strukturave 2, Mekanika e Dherave dhe Shkëmbit, Konstruksione Metalike + Beton Arme, Dinamika e strukturave dhe inxhinieria sizmike, Dyshemetë rrugore, hekurudhore dhe aeroportuale. Në vit të dytë vijohet me Mekanika e Themeleve, Gjeologjia e Aplikuar, Projektim Urbanistik 1 Topografi dhe Hartografi Punimi i diplomës, Restaurimi dhe perforcimi i strukturave, Praktike profesionale, Punimi i diplomës. Studentët zhvillojnë laboratore në lëndën e hartografi dhe topografi (laborator në pronësi të KPT po që në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit zhvillohet edhe nga UET), praktikë profesionale. Të gjitha më sipër ndihmojnë studentin në punësim.</p> <p><i>Referencë: Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Ndërtimi; Plani mësimor i programit - MSH Inxhinieri Ndërtimi</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat dhe veprimtaritë formuese që ofrohen mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit MSh në Inxhinieri Ndërtimi. Studimet në këtë cikël janë 120 ECTS të ndara në 4 semestra. Kjo ndarje mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxëniet. Gjithashtu kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, praktika dhe seminarët risin mundësinë për të arritur objektivat formuese të studentit.</p> <p><i>Referencë: Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Ndërtimi; Plani mësimor i programit - MSH Inxhinieri Ndërtimi</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Referencë: Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Ndërtimi; Plani mësimor i programit - MSH Inxhinieri Ndërtimi</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti”</p>

<p>teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme inxhinierike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një kompani ndërtimi.</p> <p><i>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se praktikatat profesionale të studentëve paraqesin mangësi, kjo pjesërisht e justifikuar nga situata e jashtëzakonshme për shkak të pandemisë. Një tjetër problematikë e praktikave profesionale, është edhe kryerja e praktikës në objekte civile dhe jo ato infrastrukturore. GVJ rekomandon që për të gjithë studentët master praktika të kryhet në kompani projektimi/ zbatimi infrastrukture ose institucione të dedikuara për infranstrukturën.</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, konsultohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga drejtuesi i departamentit. Si rregull programet e lëndëve/moduleve bazohen në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Gjatë shqyrtimit të dosjes së vetëvlerësimit vihet re që pjesa më e madhe e sylabuseve kanë literaturë mjaft të vjetër, të disa dekadave të mëparshme. Gjithashtu shumë nga titujt e propozuar në sylabus nuk janë pjesë e bibliotekës së institucionit. GVJ rekomandon rishikim të detajshëm të sylabuseve dhe përfshirjen e literaturës bashkëkohore në brendinë e tyre. Gjithashtu GVJ rekomandon që stafi akademik të nxis studentët të përdorin më shumë bibliotekën, duke siguruar kopje fizike të librave të përfshirë në sylabus.</i></p> <p><i>Referencë: Dosja e vetëvlerësimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë.</p>

	Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke tentuar të krijojë bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.			
Kriteri 8. Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut.			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Institucioni realizon vazhdimisht veprimtari të formimit teorik e shkencor, duke bërë të mundur aftësimin me njohuri të avancuara për studime e analiza të nevojshme për ciklin e tretë të studimeve.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti”, është me grada shkencore dhe tituj akademikë, si edhe kualifikim Msc. Personeli akademik ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. Personeli akademik i brendshëm (PAE) sipas viteve rezulton se është me këtë kualifikim .(Bazuar në tabelën 6.1 dhe 6.2 -

Stafi akademik për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", Bazuar në tabelën 7

	PAE		PAK		PAE / PAK	PAE / PAK
	2019-2020	2020-2021	2019-2020	2020-2021	2019-2020	2020-2021
Prof. Dr	1	1	0	0	1/0	1/0
Prof As	1	1	1	2	1/1	1/2
Dr/PhD	2	1	2	4	2/1	1/4
Msc	0	0	0	1	0/0	0/1
Msc	0	0	1	0	0/1	0/1
Totali	4	3	4	7	4/4	3/7

Në nivel departamenti për vitin 2018-2019 (Tabela 2), DIA ka patur të angazhuar 7 staf PAE (vetëm 3 me tituj dhe grada, 4 me titull MSc) dhe 2 staff PAK (me titull doktor). Mungojnë të dhëna për stafin përgjegjës për programin e studimit për këtë vit akademik

Vihet re prezenca e stafit me titull MSc si titullar lënde. Kjo gjë bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi.

Pra në të vitin akademik 2020-2021 stafi efektiv është më pak se 50 e stafit total të programit. 70% e programit mbulohet nga staf me kontratë. *GVJ rekomandon shtimin e stafit akademik efektiv me grada dhe tituj pasi gjëndja aktuale është shumë larg standardeve të paracaktuara. Gjithashtu rekomandohet zerimi i stafit me titull MSc si titullar lënde në programin e studimit MSc.*

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit MSH në "Inxhinieri Ndërtimi" profile Infrastrukturë Transporti, në pjesën më të madhe zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie. *Megjithatë vihet re që pjesë e stafit akademik janë pa gradën doktor, vetëm me gradën MSc që japin mësim në këtë program studimi.*

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit të zhvilluar me stafin akademik, u konstatua se niveli

<p>studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik që mbulojnë programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit dhe moduleve të tij. Specifikisht, stafi akademik është i Specializuar në disiplina të ndryshme të Inxhinierisë së Ndërtimit si: inxhinieri stukturash, Topografi, etj. Lëndët ofrohen nga pedagogë me tituj akademikë (përveç një lënde që ofrohet nga staf pa gradën përkatëse) dhe disa lëndë mbikëqyren nga disa pedagogë. <i>Gjatë vizitës në Institucioni u kërkua që për secilin staf akademik të jepej lënda që ai/ajo mbulon së bashku me publikimet përkatëse të gjithë secilit. Ky document nuk na u vu në dispozicion nga Institucioni.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit ose kompani të ndryshme. Marrëveshjet realizohen nëpërmjet Zyrës së Karrierës, me qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të ciklit të dytë të studimeve në Inxhinieri Ndërtimi. Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me ndërmarrjet / punëdhënësit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Në Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës nuk ka personel ndihmës akademik. Kjo lidhet edhe me mungesën e laboratorëve të dedikuar për inxhinierinë e ndërtimit. <i>GVJ rekomandon shtimin e laboratorëve të dedikuar për inxhinierinë e ndërtimit dhe më specifikisht për infrastrukturën e transportit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmirësimit të programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me</p>	<p>Universiteti përdor të dhëna cilësore dhe sasiore për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, duke</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 34

<p>kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>përfshirë studentët dhe palët e interesuara si Bordi i Tregut të Punës, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga universiteti.</p> <p>Para fillimit të çdo viti akademik zhvillohen takime pune për të parë nevojën e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit. Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga departamenti përkatës. Vendimet për rishikimin e kurrikulave merren mbi bazën e propozimeve të njësive bazë. Pas kësaj vendimet e njësive bazë kalojnë për miratim në këshillin e fakultetit dhe në senat.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UET synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimarrëse të Institucioni. Prej disa vitesh pjesë të Bordit të tregut të punës janë edhe student te UET Alumni. Universiteti përdor të dhëna cilësore dhe sasiore për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara si Bordi i Tregut të Punës, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga universiteti.</p> <p>Para fillimit të çdo viti akademik zhvillohen takime pune për të parë nevojën e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit. Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga departamenti përkatës. Vendimet për rishikimin e kurrikulave merren mbi bazën e propozimeve të njësive bazë. Pas kësaj vendimet e njësive bazë kalojnë për miratim në këshillin e fakultetit dhe në senat.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET.</p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., Institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Institucioni është gjithmonë i gatshëm të përshtasë programet e studimit sipas nevojave madhore kombëtare.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Institucioni ka objektiva të qarta përsa i përket kërkimit shkencor. Referuar planit strategjik të Universiteti European i Tiranës, për periudhën 2021 – 2025, lidhur me vizionin, prioritetet dhe objektivat strategjike, si edhe planin strategjik të njësisë bazë (DIA), GVJ konstaton që programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti”, ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit. Rekomandohet që në planin strategjik të institucionit në pikën 2 “Prioritetet e kërkimit shkencor”, të shtohen si fusha të kërkimit shkencor edhe inxhinieria e ndërtimit
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Personeli akademik në UET ka liri akademike dhe gjithashtu bëhet pjesë e aktiviteteve artistike, punëve kërkimore etj, duke respektuar gjithnjë mësimdhënien.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Si të tilla janë Ditët e Studimit Shqiptar ku studentët nxiten të marrin pjesë si dëgjues apo të prezantojnë punimet e tyre. GVJ rekomandon përfshirjen më të madhe të studentëve në aktivitete të institucionit. Nga takimi me studentët na u tha që ata janë të informuar për organizime të ndryshme të Institucioni por nuk janë pjesë e tyre. Kjo mund të vijë edhe si rezultat i kohës së shkurtër që studentët janë në shkollë (mesatarisht cdo ditë 3 orë nga ora 17:00 – 20:00). Angazhimi i studentëve të programit master ishte minimal edhe gjatë vizitës që GVJ kreu në institucion, ata nuk u paraqitën në takimin e paracaktuar. GVJ për këtë arsye riorganizoi takimin. Rekomandohet që institucioni të rishikoj mundësinë që studentët të jenë në shkollë gjatë orëve normale të punës që të kenë mundësi të jenë pjesë e aktiviteteve, të aksesojnë shërbimet e ofruara si biblioteka, laboratore, etj.
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. Ky program mbështetet në strategjinë institucionale të UET, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale dhe ato të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës si dhe atyre të vetë Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, bën të

	<p>mundur ruajtjen e koherencës së kurrikulës së programit me njohuritë dhe zhvillimet më të fundit në fushën e studimeve, aftësimin për kërkim shkencor në drejtimet me të reja dhe me përmbushjen e kërkesave të tregut të punës. Gjithashtu, nëpërmjet tij, garantohen: mbështetja e studentëve lidhur me veprimtaritë akademike gjatë realizimit të programit; lidhjet e drejtpërdrejta me tregun e punës, me qëllim punësimin e studentëve, si dhe trajnimet e mëtejshme profesionale.</p> <p><i>Referencë: "Planin Strategjik për Zhvillimin e Programeve" (bazuar në Plani Strategjik Për Zhvillimin e Programit të Studimit "Master i Shkencave" në "Inxhinieri Ndërtimi")</i></p>			
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga Institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik na u tha që Institucioni stimulon stafin për aktivitete kërkimore dhe shkencore duke i përfshirë në aktivitete dhe projekte të ndryshme. <i>Stimulimi nuk ishte në trajtën e mbështetjes financiare. GVJ rekomandon shtimin e një buxheti të dedikuar për kërkimin shkencor për stafin akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.8 Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>FIIA është e angazhuar në mbështetjen e stafit akademik dhe projekteve shkencore kërkimore. Institucioni ka marrëveshje me institucione të tjera për realizimin e punëve kërkimore shkencore, duke vënë në dispozicion të dhëna dhe infrastrukturën që Institucioni disponon.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>DIA angazhohet për tu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor e shkencor dhe angazhon stafin dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. Për programin e studimit, kemi një staf të angazhuar në projekte ndërkombëtare por asnjë student.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>DIA mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Si të tilla janë Ditët e Studimit Shqiptar ku studentët nxiten të marrin pjesë si dëgjues apo të prezantojnë punimet e tyre. Ky aktivitet është për të gjithë insitucionin. <i>Duke parë cilësinë e stafit akademik, GVJ</i></p>

	<i>rekomandon që departamenti të organizoj konferenca apo takime shkencore të dedikuara për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Universiteti Europian i Tiranës ka përgatitur documentë, të cilët udhëzojnë pedagogët për mënyrën e hartimit të syllabuseve, për metodat e mësimdhënies, përzgjedhjen e literaturës, etj.</p> <p>Universiteti Europian i Tiranës ka hartuar udhëzues për mënyrën e hartimit të syllabuseve, për metodat e mësimdhënies, përzgjedhjen e literaturës, etj.</p> <p>Universiteti organizon trainime të personelit akademik.</p> <p><i>GVJ rekomandon përdorimin e metodave më bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësim nxënie. UET ka qënë pjesë e disa projekteve shumë frytëdhënëse lidhur me përmirësimin e metodave të mësimdhënies, CONSUS project. GVJ rekomandon masivizimin e përdorimit të materialeve didaktike të prodhuara nga projekti.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Drejtuesi i departamentit është direkt personi përgjegjës për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni kryen monitorimin sistematik të stafit nëpërmjet disa mekanizmave që shpjegohen në RVB. Vlerësimi synon përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Vlerësimi kryhet me metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta,</p>

	<p>të fshehta, duke përfshirë edhe studentët. Aplikohet edhe kontrolli i drejtpërdrejtë në mësim nga ana e drejtuesit të departamentit. Janë përgatitur formularët e vetëvlerësimit, si edhe formularët e vlerësimit të studentëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon nxitjen e studentëve në plotësimin e formularëve të vlerësimit, pasi përqindja ishte relativisht e ulët.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucion siguron përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, duke përfshirë edhe mundësinë e trajtimit të ankesave. Metodatat e përdorura shpjegohen RVB. Janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të fshehta (ku ruhet anonimat) dhe të hapura.</p> <p>Për sa i takon ankesave, studenti i drejtohet titullarit të lëndës për sqarime/ankesa. Nëse nuk merr përgjigje atëherë i drejtohet drejtuesit të departamentit, bazuar edhe në rregulloren e institucionit.</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në mënyrë shumë të kujdesshme, për të mos cënuar objektivitetin e kryerjes së detyrës nga pedagogu. Gjithsesi drejtuesi i departamentit ia bën të ditur rezultatet e vlerësimit personelit akademik. Më tej departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, si edhe nxjerr përfundimet përkatëse. Takimet “folloë up” kryhen në mënyrë të individuale ndërmjet pedagogut dhe drejtuesve të Institucioni</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Institucioni promovon shembujt të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të shquara. Nga ana tjetër, Institucioni është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit si Erasmus + KA1 ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse. Gjithashtu, Institucioni promovon shembujt e praktikave më të mira përmes mjeteve të tij të komunikimit siç janë emaili ose faqja e internetit e universitetit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Ndarja e tyre në program është si më poshtë: <ul style="list-style-type: none">- Leksione 420 orë mësimore- Praktikë/Seminare 160 orë mësimore- Laboratorë 68.4 orë mësimore- Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor - 288 orë mësimore- Diploma 36orë mësimore- Praktika profesionale 255 ore mësimore- Punë individuale e st. 238 orë pune- Gjithsej 1227 orë mësimore ne auditor dhe 238 punë e pavarur Përveç kësaj Departamenti i Inxhnierisë dhe Arkitekturës organizon edhe leksione të hapur me ekspertë të fushës së ndërtimit.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Mësimdhënia në Universiteti European i Tiranës rezulton e larmishme, në varësi të specifikave të lëndëve dhe nevojave të studentëve. Ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht nivelit të përgatitjes së tyre. Format e mësimdhënies mbajnë parasysh rezultatet e vlerësimeve të ndryshme, të kryera herëpashere.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të	Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe Ëorkshope me profesorë të ftuar nga universitete të

<p>përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>ndryshme. Departamenti ka organizuar disa aktivitete me përfaqësuesit e industrisë së Ndërtimit për të kuptuar më mirë pritshmëritë e tregut. Rekomandohet shtimi i ndërveprimit me tregun e punës nëpërmjet leksioneve të hapura nga përfaqësues të industrisë.</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Stafit ka ekspertizën e duhur për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik. Rekomandohet një shpërndarje më uniforme e ngarkesës dhe e lëndëve, jo vetëm brënda programit të masterit shkencor por edhe ndërmjet Masterit dhe Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi. Profesorët titullar të lëndës rekomandohet të kenë punime ose artikuj në fushën apo në lëndën specifike që ata ofrojnë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nëpërmjet mënyrave të ndryshme (të shpjguara në RVB) Institucioni thith mendimet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me problematikat e procesit mësimor. Pas kësaj drejtuesi i departamentit kryen verifikimet përkatëse dhe propozon masat përkatëse, të cilat konsistojnë në ndryshimin e rregulloreve apo të zëvendësimit të pedagogut, i cili nuk e ka kompetencën e duhur profesionale dhe didaktike.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe nga bisedat me studentët konstatoi se metodat e mësimdhënies janë ato klasike, duke u përpjekur të përfshijnë studentët sa më shumë në diskutime dhe zgjidhje të situatave konkrete, shoqëruar me kalkulimet përkatëse dhe vizatimet grafike.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi i mësimdhënies dhe ai shkencor kryhen në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen si duhet. Institucioni ka pasur ambiente cilësore që nga fillimi i tij. Një ekip me teknikë është i punësuar, që të përkujdeset për të gjitha objektet, përfshirë materialet, sistemin elektrik, ngrohjen e të gjitha ambjenteve të brendshme në dimër, ajrin e kondicionuar gjatë verës, etj.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Ambientet e dedikuara për procesin e mësimdhënies janë të kompletuara mirë me pajisjet e nevojshme, duke përfshirë projektorë, tabela smart, kompjuter në laboratorë dhe instrumente eksperimentale, internet, etj. <i>GVJ konstaton që mungojnë laboratorët e testimit të materialeve dhe programet kompiuterike që përdoren janë tërësisht të destinuar për lëndët jo inxhinierike. Mungon programi kompiuterik për studentët e inxhinierisë së ndërtimit. GVJ Rekomandon pajisjen e Institucioni me laboratore të dedikuara për studentët e MSH në Inxhinieri Ndërtimi profili Infrastrukturë transporti.</i>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të ndryshme informatike dhe infrastrukturë të konsoliduar të IT-së të nevojshme për procesin e mësimdhënies. Sistemi LMS bën të mundur që studenti në kohë reale të njihet me materialet e depozituara nga pedagogët.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	Bazuar në RVB, Institucioni vë në dispozicion një numër të përshtatshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës. <i>Gjatë vizitës në institucion, biblioteka ishte duke u sistemuar dhe nuk patëm mundësi të shohim tekstet e dedikuara për programin e studimit. Nga sylabuset vihet re që tekstet e rekomanduara janë mjaft të vjetër dhe kanë nevojë të përditësohen. GVJ rekomandon shtimin e titujve bashkëkohorë në fondin e bibliotekës dhe nxitjen e studentëve në përdorimin e saj pasi studentët na thanë që bibliotekën e frekuentojnë pak ose aspak.</i> Gjatë vizitës në Institucioni na u tha që bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në

	shërbim të studentëve. Universiteti gjithashtu ka arritshmëri në një numër bibliotekash online. Programi i studimit shfrytëzon edhe Moodle LMS për shpërndarjen e literatures me studentët.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka ka një fond librash për secilin nga programet e studimit të ofruar nga Universiteti. Universiteti ofron ambiente komode për lexim dhe sallë studimi. Bazuar ne RVB, Institucioni vë në dispozicion një numër të përshtatshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës. <i>Gjatë vizitës në institucion, biblioteka ishte duke u sistemuar dhe nuk patëm mundësi të shohim tekstet e dedikuara për programin e studimit. Nga sylabuset vihet re që tekstet e rekomanduara janë mjaft të vjetër dhe kanë nevojë të përditësohen. GVJ rekomandon shtimin e titujve bashkëkohorë në fondin e bibliotekës dhe nxitjen e studentëve në përdorimin e saj pasi studentët na thanë që bibliotekën e frekuentojnë pak ose aspak.</i> Bazuar ne RVB, biblioteka pasurohet çdo vit. Librat e bibliotekës janë inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	GVJ konstatoi se personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë pak bibliotekat online të fushave të përafërta me programin e studimit. Po ashtu edhe biblioteken fizike.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Infrastruktura laboratorike paraqet mangësi. Institucioni dhe programi i studimit <i>rekomandohet të risë kapacitetet laboratorike dhe ta këtë një nga prioritetet kryesore. Mungesa e laboratorëve të testimit të materialeve, të testimit të elementëve konstruktiv dhe labororet e simulimit, i jep programit të studimit një karakter jo shkencor. I vetmi laborator në shfrytëzim nga studentët master është laborator i topografisë.</i>
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Stafi akademik përdor rregullisht e-learning. Në funksion të mësimdhënies personeli akademik përdor platformën Moodle LMS dhe Microsoft Teams. Gjatë periudhës së pandemisë kjo platëformë u përdor edhe për procesin e kryerjes së mësim dhënies.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Nëpërmjet Moodle LMS personeli akademik dhe studentët shkëmbejnë informacione dhe materiale të ndryshme. Studenti ka arritshmëri në materialet e depozituara nga pedagogu, ku përfshihen leksione, ushtrime, etj.
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të	Departamenti i Inxhnierisë dhe Arkitekturës vë në dispozicion të studentëve listën emërore të anëtarëve të

diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	stafit akademik, të cilët mund të udhëheqin tema diplomash. I gjithë procesi, duke filluar nga miratimi i temës së diplomës e deri tek dorëzimi, është rregulluar me një procedurë të standardizuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë është krijuar komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë si një strukturë autonome dhe përhershme. Ky komision vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore, duke propozuar ndryshime dhe përmirësime, të cilat i gjykon të arsyeshme. Komisioni bashkëpunon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore dhe bazë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. UET ka hartuar edhe një manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Departamenti i Inxhnierisë dhe Arkitekturës është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin studimor MSH në Inxhinieri Ndertimi profili Infrastrukturë Transporti. Departamenti, me anë të nje programi vjetor aktivitetesh, ëorkshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit. Specifikisht për studentët e rinj, departamenti organizon javën e orientimit në fillim të çdo viti akademik. Departamenti për zgjedh personelin akademik, që angazhohet në mësimdhënie, shpërndan ngarkesën mësimore, miraton silabuset, vlerëson ecurinë e mësimdhënies me mënyra direkte dhe indirekte.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	DIA, si njësia bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë, struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Metodat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës,

	<p>leksioneve, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, praktika laboratorike, aplikime studimore, ndërveprimet me të ftuar nga fusha e ndërtimit, praktika profesionale, vizita në terren, aktivitete vullnetare, projekte dhe anëtarësime në klubet studentore dhe aktivitete të tjera jashtë shkollore. <i>GVJ rekomandon përdorimin e metodave më bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësim nxënie. UET ka qënë pjesë e disa projekteve shumë frytëdhënëse lidhur me përmirësimin e metodave të mësimdhënies, CONSUS project. GVJ rekomandon masivizimin e përdorimit të materialeve didaktike të prodhuara nga projekti.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në RVB, IAL në bashkëpunim me qendrën e metodologjisë dhe kërkimit ofrohen trajnime 1 ditore për të rritur aftësinë e stafit akademik për të ndërmarë punë kërkimore të pavarura që të jenë të botueshme në revista me faktor impakti. Trajnimet ndahen në 4 kategori varësisht kualifikimit të stafit.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni organizon në mënyrë periodike ëorkshope dhe aktivitete të ndryshme trainimi, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit te universitetit dhe përfshijnë trajnime në kuadër të shkëmbimeve KA1 dhe nëpërmjet lektorëve të ftuar në UET</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në statutin e Universiteti European i Tiranës, si dhe në planin strategjik të programit të studimit, personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” është përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe është i angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ u prezantua me aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik teston metoda të reja mësimore. Personeli akademik është i lirë të implementojë metoda e forma inovative të mësimdhënies, t’i analizojë ato, të reflektojë anët pozitive dhe negative, duke kryer edhe ndryshimet përkatëse në silabuset e lëndëve dhe metodat e mësimdhënies e nxënies.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për</p>	<p>Në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve janë angazhuar herë pas here lektorë dhe kërkues shkencorë për të shkëmbyer ide dhe metoda. Angazhimi i lektorëve të ftuar të cilët janë profesionist të fushës shihet si element shumë i</p>

shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	rëndësishëm për pasurimin e procesit të mësimdhënies në lidhje me tregune punës. Kjo bazuar në RVB			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjithçka i bëhet e qartë studentit gjatë javës së orientimit, si edhe nga pedagogët e lëndëve.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në javën e parë të semestrit akademik studentët njihen me programin e lëndës, përmbajtjen e saj, si edhe formën e vlerësimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në çdo silabus, në bazë të tipologjisë së lëndës, përcaktohet edhe vlerësimi i studentëve. Njoftime më të hollësishme depozitohen në platformën LMS.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Bazuar në shqyrtimin e silabuseve të lëndëve në programin studimor, në rregulloren e PS, si edhe në bisedat me studentët, njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes këtyre formave kryesore: 1) detyra praktike, 2) provimi i ndërmjetëm, 3) detyra kursi, 4) provimi përfundimtar, 5) prezantime, 6) projekte.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të PS konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Janë përcaktuar periudha kohore të dedikuara për provimet, provimet e ndërmjetëm dhe provimet përfundimtare. <i>Referencë: Plani mësimor i programit - MSH Inxhinieri Ndërtimi</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sisteme elektronike të testimit janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë. Me kalimin e kësaj periudhe testimi i studentëve kryhet me metoda klasike.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Provimet vlerësohen vetëm nga pedagogu, i cili është titullari i lëndës. Provimi mund të vlerësohet edhe nga asistenti i titullarit të lëndëve, kur ky i fundit e gjykon të arsyeshme. Praktika profesionale si edhe punimi i diplomës vlerësohen detyrimisht nga komisioni përkatës. <i>GVJ rekomandon përfshirjen e detyrueshme të asistentit në vlerësimin përfundimtar pasi kjo do të riste shkallën e kontrollit në vlerësimet finale.</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe Institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Institucioni ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin e provimeve në anonimat të plotë. Aplikohet sekretimi i fletëve të provimit, mbikqyrja e sallave nga dy pedagogë të caktuar nga drejtuesi i departamentit. Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi deri sa dorëzohen në sekretari.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pike/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi. Gjatë takimit me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv mbi komentet, keshillat dhe rekomandimet e pedagogeve në mënyrë që të ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti, nëpërmjet rregulloreve të tij, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Gjatë zhvillimit të provimeve salla monitorohet nga dy apo më shumë pedagogë të caktuar e të miratuar nga drejtuesi i departamentit. Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohen me notën 4 (katër).

	<p>Bazuar në RVB, përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor programin Turnitin ephorus si një mekanizëm që kontrollon plagjiaturën për punimet e studentëve. <i>Gjatë takimit me stafin akademik, kur u pyetëm mbi mëyrën e kontrollit të plagjiaturës, asnjë antarë i stafit nuk e përmendi softëare të mësipërm. GVJ rekomandon masivizimin e përdorimit të Turnitin si në temat e diplomave ashtu edhe në punimet simestrale.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Afatet e perfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qarte dhe të shpallura. Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritën e studentëve</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregulloreve, si dhe nga konstatimet gjatë vizitës në universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankesë në departament. Ankesa paraqitet në formën e një formulari të veçantë, brenda një jave pas shpalljes së notave përfundimtare. Përveç anës formale, në UET eksizton edhe tutoring, një praktikë e njohur ndërkombëtarisht, ku përgjegjësi i departamentit mer dhe ndjek të gjitha ankesat e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë drejtuesit të departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën.</p> <p>Me marrjen e ankesës, drejtuesi i departamentit ose dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë drejtuesi i departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil “Infrastrukturë Transporti” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit dytë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e tretë. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit nuk ofron lëndë specifike lidhur me teknologjinë e informacionit, shkencave humane sociale apo komunikimin. Bazuar në sylabuset e paraqitura nga IAL, disa nga këto component përfshihen në lëndë të tjera. <i>GVJ rekomandon që programit të studimit ti shtohen lëndë që kanë të bëjnë me softëare modelimi të objekteve civile dhe infrastrukurore, lëndë që kanë të bëjnë me menaxhimin e kantjerit apo të kompanive si dhe lëndë që kanë të bëjnë me komunikimin. Profesioni i Inxhnierit të ndërtimit është i tillë që kërkon vec të tjerash edhe aftësi shumë të mira komunikuese, dhe si i tillë ka nevojë për lëndët e sipërpërmendura.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe sylabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe sylabuset e çdo lënde, analizohen në përfundim të semestrit akademik. Pedagogët tërheqin mendimin e studentëve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të përmbajtjes së lëndëve. Si një test për të kuptuar se sa kanë përfituar studentët shërben edhe detyra e kursit apo detyra praktike, që realizohet në fund të lëndës.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në përfundim të çdo lënde pedagogu thekson problemet më të rëndësishme, të cilat do t’u nevojiten studentëve, duke i këshilluar ata për mënyrën e implementimit të tyre. Gjatë takimit në institucion, si me stafin akademik ashtu edhe me studentët, na u konfirmua që të gjithë profesorët në përfundim të lëndës bëjnë një përmbledhje dhe i përgatisin studentët për testin final.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të	Personeli akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe

hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	simpoziume, merr pjesë dhe organizon ëorkshope, si dhe zhvillon aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Personeli akademik nxitet nga departamenti të prezantojë punët e tyre apo eksperiencat e tyre në projekte specifike. Këto të fundit prezantohen në trajtën e leksioneve të hapura ku të gjithë janë të ftuar të marrin pjesë.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, te cilat janë të mirëpercaktuara në programët lëndore. Studentët e programit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil "Infrastrukturë Transporti" kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, si dhe në praktikat profesionale. <i>Mungesa e laboratorëve të dedikuar për inxhinierinë e ndërtimit e bënë të vështirë aplikimin e kompetencave teorike të fituara. Praktika profesionale i ndihmonë shumë studentët në aplikim konkret të dijeve të mara. GVJ rekomandon që praktika profesionale të kryhet pranë kompanive apo institucioneve të dedikuara për infrastrukturë transporti.</i>
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil "Infrastrukturë Transporti".
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. Universiteti u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera, duke i mbështetur ato edhe financiarisht. <i>GVJ rekomandon që departamenti të nxis dhe stimuloj akoma më shumë studentët të përfshihen aktivisht në grupet e sipërpërmendura dhe gjithashtu të krijoj grupin e dedikuar për inxhinierët e rinj.</i>
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të	Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, lista e të cilave është vënë në dispozicion të GVJ. Universiteti European i Tiranës shkëmben përvojën e tij me këta universitete duke mundësuar rritjen e

mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	mobiliteteve të studentëve. Si rezultat i pandemisë dhe i kohës së shkurtër që programi i studimit ekziston, mobilitetet e studentëve akoma nuk janë aktive, por nga takimi që patëm me zyrën e projekteve na u tha që programi i studimit do të përfshihet në projekte ndërkombëtare shumë shpejtë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Procedura për mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar në faqen e internetit, nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht. Kjo procedurë është e sanksionuar në rregulloret e institucionit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Informacioni dhe udhëzimet mbi përgatitjen dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është i publikuar. Të gjitha procedurat që ndiqen janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nga vizita në universitet, vërehet që studentët përzgjedhin udhëheqësin sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ata të kryejnë punën e tyre kërkimore shkencore.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në rastin e studentëve të prograimit MSH në Inxhnieri Ndërtimi me profil Infrastrukturë transporti, detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Pedagogu përgjegjës organizon dhe ndjek orarin e konsultimit të realizuar nga pedagogët e secilës nëndisiplinë. Udhëheqësi i diplomës zhvillon seanca metodologjike me studentët diplomantë. Deri tani programi i studimit ka diplomuar vetëm 2 studentë, prandaj praktika e diploimit ka nevojë të konsolidohet. Megjithatë departamenti i ka të gjitha procedurat në vend dhe i aplikon ato. Staf i akademik i orienton dhe i ndihmon studentët në përcaktimin e temave të diplomave. Gjatë takimit me studentët e masterit na u tha që është shpërndarë lista e temave të mundshme së bashku me profesorët përkatës.

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni ka gadishmërinë të asistoj studentët për kryerjen e matjeve apo testeve në mjediset e institucionit apo edhe jashtë tij. Mangësitë në bazën laboratorike e çënojnë shumë këtë asistencë.			
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës ndihmon studentin në shkrimin e temës së diplomës, në arritjen e përfundimeve, si edhe nxjerrjen e rezultateve përkatëse. Mangësitë në bazën laboratorike ndikojnë në këtë proces. <i>Gjatë vizitës në IAL, më specifikisht pranë sekretarisë mësimore na u paraqitën edhe kopjet e diplomave të dy studentëve të diplomuar në programin e studimit MSH në Inxhnieri Ndërtimi. Gjatë shqyrtimit të temave u konstatuan shumë mangësi në to. Si përshëmbull mungesa e firmës nga udhëheqësi apo referencat. U panë diplomat e Valbona Hasanaj (Msc) Diploma ishte e pafirmosur nga udhëheqësi dhe pa referenca. Ardi Kaci (Msc) Diploma pa referenca. Nota e vlerësimit të diplomave ishte maksimale por kërkohet më shumë vëmendje nga departamenti në diplomimin e studentëve.</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, nga sekretaria mësimore, studentit i vihen në dispozicion kopje zyrtare, të silabuseve të PS. Në suplement pasqyrohen të dhëna të detajuara mbi programin e studimit të zhvilluar.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Institucioni ka krijuar një bazë të dhënash të plotë për të gjithë procesin mësimor në vite. Dokumentacioni ruhet për një periudhë pa afat. Të dhënat statistikore përpunohen periodikisht sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, agjencisë së sigurimit të cilësisës, apo të vetë institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Referuar RVB si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se në Universiteti Europian i Tiranës mblidhen, ruhen dhe përditësohen çdo vit akademik të dhënat personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Në lidhje me mbledhjen e këtyre të dhënave Universiteti Europian i Tiranës, nëpërmjet zyrës së burimeve njerëzore, krijon dosjen individuale të personelit akademik. Zyra e burimeve njerëzore mban evidencë edhe për ngarkesën mësimore të personelit akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p>GVJ rekomandon përditësimin e CV të stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ gjeti që procedurat e rekrutimit të personelit akademik në Universiteti Europian i Tiranës përcaktohen në rregulloren për burimet njerëzore. Këto procedura janë në përputhje me statutin e Universiteti Europian i Tiranës, ligjet kombëtare shqiptare, që disiplinojnë rekrutimin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ● Kodi i Punës i Shqipërisë, etj. <p>Gjatë takimit në zyrën e burimeve njerëzore GVJ u interesua të njihet konkretisht me zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit dhe gjeti që ato ishin kryer konform akteve ligjore e nënligjore. Më specifikisht procedura e rekrutimit është si më poshtë bazuar në takimin që GVJ pati me zyrën e burimeve njerëzore: Përgjegjësi I departamentit planifikon ngarkesën për stafin akademik. Përpiqen të bëjnë mbulim maksimal të lëndëve me staf akademik efektiv.</p> <p>Hapet thirrja në faqen ËEB të UET, por edhe gjatë gjithë vitit marrin emaille për shprehje interesi për staf akademik. Bëhet seleksionimi I dosjeve për intervistim, më pas ngrihet komisioni. Vlerësimi në komision bëhet me pikëzim.</p> <p>Kontratrat për stafin akademik me gradë ose titull Shkencor bëhen pa afat ndërsa për stafin me Msc 1 vjecare. Nqs</p>

	<p>kontrata 1 vjecare përsëritet tre vite rradhazi procedohet sipas Kodit të Punës.</p> <p>Pas përzgjedhjes së stafit del vendimi I rektorit. Kontratat për personel akademik me kohë të pjesshme janë semestrare.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik na u tha që funksionon edhe rekomandimi si proces rekrutimi.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ i konsultoi të gjitha kriteret dhe procedurat e posaçme e specifike për rekrutimin e personelit të shenjura në dokumentat bazë si rregulloren për burimeve njerëzore, statutin e Universiteti European i Tiranës, rregulloren e PS, etj., dhe i gjeti ato të hartuara në përputhje të plotë me bazën ligjore dhe të zbatuara gjatë gjithë aktivitetit për rekrutimin e personelit. <i>Gjatë vizitës në IAL dhe në zyrën e Burimeve Njerëzore, konstatoam që pjesa më e madhe e stafit të jashtëm ka mangësi në dokumentacionin e detyruar (dosjet e stafit).</i></p> <p>GVJ rekomandon plotësimin e dosjeve të të gjithë stafit qoftë i jashtëm ose i brëndshëm. Më specifikisht për stafin e jashtëm kërkohet leja nga punëdhënësi kryesor. Duke qënë që programi i studimit ka më së shumti staf të jashtëm, ky document është mëse i nevojshëm.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi fillimisht RVB ku thuhet se përzgjedhja e personelit akademik zhvillohet që nga momenti i rekrutimit e në vazhdim. Procedurat e standardizuara tregohen në rregulloren për burimet njerëzore. Të gjitha këto procedura ndiqen nga zyra përkatëse e burimeve njerëzore. Procesi i rekrutimit mbështetet në nevojat për personel, të cilat i paraqiten zyrës së burimeve njerëzore nga të gjitha departamentet dhe njësitë kryesore. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit ndiqej me rigozitet e transparencë. GVJ gjykon që kjo procedurë garanton rekrutimin e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e PS. GVJ rekomandon që për programin e studimit MSH në Inxhnieri Ndërtimi profile Infrastrukturë transporti stafi akademik i përzgjedhur duhet të jetë me grada dhe me tituj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efektive dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet e punës të personelit akademik të DIA. Ai i gjeti këto ambiente të përshtatshme dhe shumë funksionale për kryerjen e detyrave mësimore e kërkimoro shkencore. Kjo u pohua edhe nga pjesëtarët e personelit në takimin që GVJ organizoi me ta.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Referuar RVB, GVJ konstaton që Universiteti Europian i Tiranës organizon vazhdimisht trainime për stafin e tij akademik me qëllim aftësimin profesional të stafit, në perputhje me përcaktimet e statutit të tij. Institucioni mbështet zhvillimin e konferencave shkencore dhe botimin e artikujve në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Për më tepër, stafi akademik inkurajohet shumë për të marrë pjesë në projekte të shkëmbimit të stafit “Erasmus+” me universitete të tjera partnere. Anëtarë të stafit na thanë që nëpërmjet këtyre pjesmarrjeve ata kanë shkëmbyer përvoja dhe janë njohur me politikat e menaxhimit dhe strategjitë e zhvilluara në institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë në Europë dhe jashtë saj.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	GVJ gjen që në Universitetin Europian të Tiranës trainimet e stafit përbëjnë një pjesë solide të planit strategjik. Këto trainime synojnë zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit. Disa nga trajnimet e realizuara kanë qenë për arsimin dixhital sidomos gjatë periudhës së pandemisë. GVJ u interesua për stadin e zhvillimit të mësimit online në këtë institucion. Në përgjigje të këtij interesimi ata u informuan për platformën që përdorte ky institucion si dhe për objektivat në lidhje me përsosjen e mëtejshme të kësaj metode mësimdhënieje.
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	GVJ konstaton që Institucioni dëshmon angazhimin e të gjitha burimeve njerëzore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit Master. Konkretisht, për PS MSH në “Inxhinieri Ndërtimi” pedagogët kryesorë të lëndëve të ofruara në kurikulë zotërojnë të paktën kualifikimin "Doktor". Përveç kësaj u konstatua që në programin e studimit, titular të lëndëve ishin edhe staf të cilët nuk e kanë akoma këtë titull. Kjo u vu re në dy raste. GVJ rekomandon që stafi akademik i angazhuar në PS të ketë minimalisht gradën doctor, sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në IAL dhe nga

	<i>dokumentacioni i vënë në dispozicion, u panë edhe CV e stafit. Sipas CV-ve, stafi akademik kanë një përvojë disa vjeçare në fushën specifike të lëndës që zhvillojnë por disa prej tyre nuk kanë gradat dhe titujt e nevojshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Si nga paraqitja në RVB ashtu edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti European i Tiranës vë në dispozicion ambiente të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe natyrën specifike të PS. Auditoret, laboratorët, biblioteka (akoma jo plotësisht funksionale) dhe mjediset ndërmjetëse ishin të gjitha funksionale. Studentët ishin të pajisur me kartë studenti dhe kishin akses gjatë gjithë kohës për t'i përdorur si ambientet ashtu edhe teknologjinë mësimore të vendosur në këto ambiente.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në të gjitha ambientet mësimore të institucionit që vizitoi GVJ gjeti paisje të tilla si: projektuesit video, kompjuterat dhe internetin të cilat ishin funksionale.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave	Laboratorët kanë nevojë të pasurohen me pajisje e mjete për kryerjen e provave dhe testeve të nevojshme për mbarëvajtjen e mësimit dhe konkretizimin e tij. <i>GVJ rekomandon shtimin e laboratorëve për testim materialesh dhe elementësh sturkturor.</i>

formues të programit të studimit në tërësi.				
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Universiteti Europian i Tiranës ka në përdorim shtatë laboratorë mësimorë informatike, si edhe salla mësimore të pajisuar me foni, mjeta audiovizive, kompiutera, etj. GVJ rekomandon shtimin dhe përdorimin e programeve të llogaritjeve inxhinierike për studentët.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Universiteti Europian i Tiranës garanton kapacitetet për zhvillimin e praktikave profesionale në bashkëpunim me institucione dhe organizat të ndryshme.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar RVB, IAL raporton që universiteti vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore me një sipërfaqe prej rreth 35 m ² . dhe një fond prej rreth 1100 titujsh për studentët e inxhinierisë. Biblioteka ofron si shërbimin me personel ashtu edhe shërbimin online. Personi i ngarkuar me bibliotekën ishte i gatshëm për t'i ndihmuar të interesuarit për të gjitha shërbimet. Pyetjes nëse krijoheshin probleme lidhur me postet e punës në bibliotekë punonjësi i ngarkuar me bibliotekën iu përgjigj se numri i vendeve ishte i mjaftueshëm, ndërsa orari i frekuentimit ishte funksional për pjesën më të madhe të studentëve. <i>Gjatë vizitës në IAL, biblioteka nuk ishte plotësisht funksionale, mungonte këndi i librave inxhinierik. Gjithashtu, GVJ rekomandon plotësimin dhe</i>

	përditësimin me libra bashkëkohorë të sektorit të dedikuar PS.			
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka është e pajisur me një fond të përbërë nga libra, periodikë, cd dhe harta, në shqip apo në gjuhë të tjera. Studentët mund të përdorin literaturën fizike, mund të hyjnë në libraritë elektronike të huaja, si edhe mund të konsultojnë literaturën elektronike të ofruar nga vetë biblioteka.			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Institucioni ofron shfrytëzimin e bibliotekave elektronike Sage, Ebsco dhe Questia për studentët dhe personelin akademik.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e Universiteti European i Tiranës është pjesë përbërëse e sistemit COBISS, që është një rrjet ku janë përfshirë të gjithë vendet e rajonit të europës juglindore. Cobis përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Koordinatori i PS harton një plan të detajuar për pasurimin e bibliotekës. Procedura përkatëse janë të përcaktuara në dokumentat që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. <i>GVJ rekomandon që biblioteka duhet të pasurohet më tej në fushën e inxhinierisë së ndërtimit.</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Orari i bibliotekës sipas studentëve është i përshtatshëm dhe plotëson kërkesat e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sistemi nëpërmjet të cilit UET administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët është UMIS. Sistemi i menaxhimit është një program i cili është krijuar për ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit (akademike, prodhim statistikash, financa, biblioteka, etj).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Duke ndjekur trendet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, UET ka investuar në programin MOODLE (UET LMS). Ky i fundit është një nga programet më të mira në menaxhimin e procesit mësimor. Nëpërmjet tij stafi dhe studentët kanë mundësi të komunikojnë në kohë reale dhe të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm si leksione, detyra kursi, të shohin notat, etj.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit MOODLE (UET LMS) siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. IAL e përdor këtë system që prej vitit akademik 2016-2017.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Duke ndjekur trendet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, UET ka investuar në programin MOODLE (UET LMS). Ky i fundit është një nga programet më të mira në menaxhimin e procesit mësimor. Nëpërmjet tij stafi dhe studentët kanë mundësi të komunikojnë në kohë reale dhe të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm si leksione, detyra kursi, të shohin notat, etj.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Platforma LMS është një mjet efiçent në dispozicion të KSBC. Në përfundim të çdo semestri nxirren statistikat përkatëse për çdo staf për përdorimin e platformës në fjalë
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Informacionet lidhur me programin e studimit, personelin dhe stafin gjenden në faqen e internetit të IAL. <i>GVJ rekomandon shtimin e të gjithë stafit akademik në faqen e ëeb, jo vetëm të përgjegjësit të departamentit, dhe gjithashtu plan programi i lëndëve në faqen e internetit është vetëm në gjuhën shqipe.</i>

	<i>GVJ rekomandon ti kushtohet më shumë vëmëndje programit të studimit në fjalë në të gjitha platformat online të UET.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Buxheti financiar hartohet në muajin Tetor të cdo viti për të gjithë institucionin dhe jo për program studimi. Institucioni harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Plani i financimit hartohet në nivel institucional ku përfshihen të gjitha kostot dhe të ardhurat. Raportet nuk hartohen në bazë programesh studimi por vetëm institucional.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e	Sipas Raportit të vlerësimit të brendshëm, IAL çdo vit i nënshtrohet auditimit të jashtëm përse i përket situatës financiare nga shoqëria Deloitte Albania. Raporti përmban analizën e të dhënave të shpenzimeve dhe të ardhurave të IAL si dhe të gjitha të dhënat për të ardhurat (grantet,

shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	tarifat e shkollimit të studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	UET ka raport auditiv të përvitshëm. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet si dhe kategorizimin e llogarisë përkatëse në funksion të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të studentit.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Bazuar në RVB, IAL deklaron që të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e IAL për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të PS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura (nga pranimi në dalje), duke u mbështetur në rregulloret përkatëse, burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. I gjithë informacioni publikohet online, në broshurën informuese, media, si edhe gjatë këshillimit në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Politikatat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në shqyrtimin e politikave dhe procedurave për pranimin, edukimin dhe diplomimin e studentëve, GVJ gjykon që ato garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Të gjithë ata që kanë aplikuar për programet e studimit në Universiteti Europian i Tiranës dhe fitojnë të drejtën e studimit regjistrohen si studentë zyrtarë dhe u nënshtrohen njëloj të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga ky status. GVJ konstaton që në këtë institucion, si të drejtat ashtu edhe detyrimet janë të njëjta për të gjithë studentët, që nga momenti kur marrin statusin e studentit deri kur diplomohen.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ i konsultoi procedurat e pranimit, përzgjedhjes së studentëve, ato të përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit dhe gjykon që ato janë të aksesueshme dhe të kuptueshme nga publiku. Procedurat deri në regjistrim janë procedura konkurruese të cilat gjenden në faqen zyrtare të universitetit. Ecuria e studentëve që nga momenti kur ata marrin statusin e studentit dhe deri në diplomim ndiqet nga institucioni. <i>Nga vizita në Institucioni dhe nga takimi me studentët, u konstatua që në këtë program studimi janë regjistruar student që vijnë nga fusha shumë të ndryshme nga ajo e inxhnierisë së ndërtimit. Si përshëmbull Ekonomik. Gjithashtu pjesa më e madhe e studentëve të regjistruar në master nuk vinin nga një program Bachelor në Inxhnieri ndërtimi. Edhe pse disa prej tyre vinin nga programe inxhnierike, si gjeologji, inxhnieri tekstile, etj, këta student nuk kanë marrë dijet e nevojshme për tu thelluar më tej në një program master. Përshëmbull studentët që vinin nga programet e sipërpërmenduar nuk kanë zhvilluar asnjë orë mësimi konstruksione betonarme në bachelor, por ndërkohë në programin e MSH ka lëndë Beton Arme i Avancuar, ose Special. Ose lëndët e Specialitetit. Studentët në fjalë nuk kanë zhvilluar asnjë orë në bachelor mbi infrastrukturën e transportit, dhe</i></p>

	<p><i>përballen në master në llogaritje të avancuara. Për studentin e regjistruar me bachelor në Ekonomi, situata është akoma më e rëndë pasi edhe baza matematike e zhvilluar është krejt e ndryshme nga ajo që ofrohet në programet inxhnierike.</i></p> <p><i>GVJ këtë fakt e konsideron të një rëndësie të vecantë në zhvillimin e programit të studimit. Rekomandohet që studentët që regjistrohen në master, nëse nuk vijnë me një bachelor të fushave të inxhnierisë së ndërtimit, të ndjekin lëndë në bachelor përpara se të hyjnë dhe të ndjekin lëndë në master. Nëse nuk kryehet ky proces, kjo kthehet në pengesë edhe për profesorin i cili duhet të shpjegoj bazat (të cilat zhvillohen në BSc) në mënyrë që nëse del koha të shpjegoj teorinë e avancuara. Zyra e studentëve apo e këshillimit duhet të punojë në këtë drejtim që ti orientoj studentët të thellohen në studime master në fusha të ngjashme me ato të bachelor. GJV rekomandon të rishikohet procedura e pranimit të studentëve në programin MSH në Inxhnieri Ndërtimi profile Infrastrukturë Transporti.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe eksperiencave në programe të tjera studimi MSH, Universiteti Europian i Tiranës ka hartuar kriteret specifike për pranimin e studentëve, të cilat pasqyrohen në rregulloren e PS. GVJ konstatoi që i gjithë informacioni mbi kriteret e pranimit ndodhet në faqen zyrtare të Universiteti Europian i Tiranës .</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, Institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>GVJ u informua që në institucion, para fillimit të çdo viti shkollor, kryhet një fushatë informimi për të gjithë të interesuarit, që duan të vazhdojnë studimet në Universiteti Europian i Tiranës. Të interesuarit ftohen në Universitetin Europian të Tiranës, ku ata mund të marrin informacion të detajuar për universitetin dhe programin specifik të studimit. Më pas ata marrin informacione edhe nga pedagogët përkatës të PS.</p> <p>Për të gjithë studentët e rinj organizohet java e orientimit, gjatë të cilës realizohen leksione për shpjegimin e rregulloreve, procedurave administrative, kriterëve, etj. Edhe pas kësaj të interesuarit mund t'i konsultojnë si kriteret e pranimit ashtu edhe të drejtat dhe detyrat e tyre si studentë në faqen zyrtare të institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Përveç informimit të përgjithshëm nëpërmjet faqes zyrtare në internet, e cila është e aksesueshme për gjithë të interesuarit, informacion i plotë dhe i hollësishëm lidhur me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin studenti i merr edhe përmes platformave online UMS dhe LMS. Studentët mund të tërheqin pranë koordinatores së departamentit formularin e paradiplomimit, ku tregohen lëndët, rezultatet përkatëse dhe statusi për çdo lëndë.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konsultoi RVB dhe, gjatë vizitës në institucion, mësoi për punën që bëhet në informimin e studentëve lidhur me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Në këtë kuadër konstatohet që sipas direktivave dhe rregulloreve çdo student, duke përfshirë edhe studentët e huaj, informohet rregullisht për procedurat dhe afatet e njohjes së diplomës së studimeve të mëparshme. Studentët gjithashtu informohen për njohjen e diplomës bazuar në akreditimin e programit të studimit. Në takimin me studentët GVJ mësoi që ata kishin informacionet e nevojshme lidhur me njohjen e studimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton që në Universitetin European të Tiranës studentët informohen rregullisht në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Ky konstatim konfirmohet si nga gjetjet në RVB ashtu edhe informacionet nga vizita në institucion. Përveçse në dokumentacionin ligjor të universitetit kriteret dhe procedurat e vlerësimit jepen edhe në syllabuset e lëndëve.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Edhe për këtë kriter vlen i njëjti pohim si më sipër me specifikën që me përfundimin e studimeve në Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi”, departamenti i informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, Institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe	Për të gjithë ata që aplikojnë për një program studimi në Universitetin European të Tiranës ekziston mundësia e informimit paraprak në faqen zyrtare në internet. Nga kjo faqe të interesuarit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm.

organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Gjithashtu organizohet java e orientimit ku të interesuarit ftohen në ambientet e institucionit. Gjatë javës së orientimi studentët njihen me ambientet e shkollës, personelin akademik, programet e lëndëve, rregullat dhe rregulloret, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton që informimi i studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi” bëhet më së pari nëpërmjet faqes në internet të departamentit, vazhdon me këshillimin me stafin akademik në momentin që interesohen për programin e studimit. Më tej vijohet me kontaktet me zyrën e kujdesit të studentit, rregulloren e PS, si edhe nëpërmjet kontratës në momentin e regjistrimit. Gjithashtu është edhe kontrata që nënshkruhet me UET në momentin e regjistrimit
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nëpërmjet RVB dhe vizitës në Institucion GVJ u informua mbi planin mësimor dhe programet e lëndëve të programit të studimeve Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Këto materiale u vihen në dispozicion në fillim të çdo viti studentëve të këtij programi studimi. Kjo bën që ata të jenë të mirëinformuar për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstaton se përmbushja e këtij kriteri realizohet nëpërmjet aktivitetit të zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit për studentin, e cila zhvillon veprimtarinë e saj në koordinimi me këshilluesit e karrierës për çdo fakultet. Referuar RVB, kjo zyrë edhe e trajnon edhe e mbështet studentin në krijimin e dokumentacionit sa më të përshtatshëm për të konkuruar në tregun e punës. Zyra ndërmjetëson kontaktet dhe i finalizon ato. Ajo disponon edhe vlerësimet e studentëve për praktikat që ata kryejnë në ndërmarrjet bashkëpunuese. Në institucion funksionojnë bordet e punës, si edhe organizohen panairë të punës. Gjatë vizitës në IAL dhe takimit me studentët, na u tha që një nga studentet është

	punësuar falë studimeve të sajë në UET dhe në këtë program studimi.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në universitet studentët e marrin informacion mbi zhvillimin e procesit mësimor të plotë dhe të përditësuar. GVJ konstaton se studentët i konsultojnë të gjithë burimet e informacionit. Në takimin me ta, studentët demonstuan njohje të plotë të informacionit mbi procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstaton që informacioni në lidhje me programin e studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil Infrastrukturë Transporti është i plotë dhe njihet mirë nga studentët, si edhe përdoret në çdo kohë e lehtësisht prej tyre pavarësisht nga distanca. Kjo mundësohet nga shfrytëzimi prej tyre i sistemit LMS.			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	I gjithë dokumentacioni i studentit që nga dosja e aplikimit dhe regjistrimi në programin e studimit, së bashku me lëndët që ka ndjekur dhe rezultatet e provimev ruhen në sekretarinë mësimore dhe zyrën e regjistrimit të studentëve. <i>GVJ gjatë vizitës në IAL dhe në sekretarinë mësimore, specifikisht gjatë kontrollit të rregjistrave, u vu re që kishte shumë korigjime, si në nota ashtu edhe në të dhënat e studentëve. Për këto korigjime, të bëra me korrektor, nuk kishte asnjë procesverbal të mbajtur nga personat përgjegjes dhe kryesekretarja. Në regjistrin e notave gjithashtu mungonin nota të studentëve të diplomuar, dhe mosperputhje të notës në procesverbal me atë të hedhur në regjistër. Për këtë arsye dhe për rëndësinë që ka rruajtja dhe dokumentimi i saktë i të dhënave, GVJ rekomandon shtimin e një rregulloreje apo procedure se çfarë ndodh në rast se bëhet një gabim njerëzor në regjistrat hard copy. Korigjimi i rregjistrave është një ndërhyrje e cila nuk duhet të ndodh pa procesverbalin përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Për secilin program studimi Institucioni disponon dhe mban statistika, që kanë të bëjnë me cilësinë në hyrje dhe dalje, punësimin gjatë dhe pas diplomimit, etj.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	GVJ konstaton që Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Sistemi UMIS mundëson që të dhënat statistikore të përpunohen në çdo kohë. Ky sistem aplikohet që prej vitit akademik 2006 – 2007.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Gjatë vizitës në institucion GVJ i konsultoi të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. GVJ u informua që, duke filluar nga semestri i parë deri në diplomim, çdo notë e studentëve regjistrohej në kopje fizike dhe kopje elektronike në sistem duke gjeneruar informacion të qartë mbi ecurinë e studentëve dhe performancën e tyre. Të gjitha të dhënat gjenden në sekretarinë mësimore.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i menaxhimit të informacionit të universitetit (UMIS) ruan, administron, përpunon të dhënat akademike të studentëve. Gjithashtu përfshin të dhëna financiare dhe menaxheriale, si edhe aktivitetin e bibliotekës. Pranë zyrës së IT është punësuar një person i posaçëm që merret me administrimin e të gjithë sistemit UMIS.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjestrave	Në plotësim të direktivave institucionale, në Universitetin European të Tiranës përgatiten raporte periodikë për studentët që vijnë dhe për ata ekzistues, në të cilët formatohen edhe profilet e studentëve lidhur me cilësinë në hyrje dhe atë në dalje. Zyra e planifikimit të karrierës dhe e kujdesit të studentëve të diplomuar ndjek në vazhdimësi edhe të diplomuarit duke u informuar për karrierën e tyre dhe ndikimin që kanë patur studimet në Universitetin European të Tiranës në ecurinë e tyre profesionale. GVJ konstaton që këto të dhëna

	ndikojnë në marrjen e masave sa më efektive për të rritur cilësitë e kontigjentëve të diplomuar nga ky universitet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë Institucioni - ve.</p>	<p>GVJ konstaton që universiteti ka realizuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve, përkatësisht përfaqësuesve të tyre, në organet vendimmarrëse e këshilluese. Konkretisht në këtë institucion funksionon këshilli i studentëve, të drejtat dhe detyrimet e të cilit bazohen në legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe në rregullat dhe rregulloret e Universitetit European të Tiranës. Gjithashtu studentët kanë përfaqësuesit e tyre edhe në organet e mëposhtme të institucionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senati akademik • Këshilli i etikës • Komisioni i brendshëm për sigurimin e cilësisë <p>Pjesëmarrje në mbledhjet e departamentit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton që bazuar në statutin e Universitetit European të Tiranës, studentët përfaqësohen në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik në institucion, përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur.</p> <p>Në zbatim të nenit 16, pika 2, të statutit të Universitetit European të Tiranës, në KSBC merr pjesë një anëtar nga këshilli i studentëve, në cilësinë e ekspertit të jashtëm.</p> <p>Në zbatim të nenit 19, të statutit të UET, janë anëtarë të senatit akademik edhe kryetari i këshillit të studentëve dhe dy studentë të tjerë, përfaqësues të tre cikleve të studimit, që zgjidhen nga këshilli i studentëve, me një mandate 2 vjeçar.</p> <p>Në zbatim të nenit 19, të statutit të UET, është anëtar i dekanatit edhe kryetari i këshillit të studentëve.</p>

	<p>Në zbatim të nenit 19, të statutit të UET, njëri nga anëtarët e këshillit të etikës i rekomandohet rektorit nga këshilli i studentëve.</p> <p>Modalitetet për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të studentëve, si dhe ato për organizimin dhe funksionimin e tij, përcaktohen në nenin 51 të statutit të Universiteti Europian i Tiranës .</p> <p>Përmes anëtarësimit të përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur në senatin akademik, komisionin e brendshëm për sigurimin e cilësisë, këshillin e etikës, si dhe pjesëmarrjen aktive të këtyre përfaqësuesve studentë në mbledhjet e këtyre organeve, sigurohet që përfshirja e përfaqësuesve të studentëve në vendimmarrje dhe çështje që i përkasin procesit akademik është efektive dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme dhe të matshme. Ata gjithashtu aktivizohen mëpërmjet focus grupeve, pyetësorëve online dhe angazhohen edhe në hartimet e RVB.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, Institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri GVJ konstaton që Institucioni e merr parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit kryesisht gjatë hartimit dhe përmirësimit të programit të studimit si kurikulë dhe si syllabuse. Në takimin me studentët ata u shprehën gjithashtu se ngarkesa e tyre ishte e përballeshme madje në disa raste është shumë pak dhe ka nevojë për më shumë orë mësimore.</p> <p><i>Duke parë ngarkesën akademike të studentëve, që bëjnë mësim prej orës 17:00 – 20:00, në 5 ditë të javës, GVJ konstaton që janë shumë pak orë fizike të zhvilluara në auditor. Vetëm 15 orë fizike në javë. Për të ritur pjesëmarrjen e studentëve në auditore, GVJ rekomandon shimin e orëve fizike në auditor. Kjo mund të zhvillohet nëpërmjet mësimin edhe ditën e shtunë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ gjykon se përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në Universitetin Europian të Tiranës garantohet nëpërmjet organizimit të tyre në këshillin e studentëve dhe përfaqësuesve në organet e rëndësishme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Senati akademik ● Këshilli i etikës ● Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë ● Përfshirja në mbledhjet e hapura të departamentit <p>Kjo përfshirje, siç doli edhe nga takimi i GVJ me përfaqësues të tyre ka ndikuar pozitivisht në strukturimin e kurikulës dhe syllabuseve të lëndëve</p>

<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehën se u është mundësuar të japin mendime mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit të tij dhe reflektimit nga ana e institucionit përkatësisht njësisë dhe pedagogut përgjegjës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe kontrollit të CV, personeli akademik i PS publikon rregullisht artikuj në disiplina të përkatëse. UET u mundëson të publikojnë në revistën shkencore POLIS dhe në atë NODUS si dhe të referojnë në Ditët e studimeve shqiptare.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>IAL ka lidhur marrëveshje partneriteti me 95 institucione homologe brënda dhe jashtë vendit, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore. Tashmë që departamenti ka revistën e tij shkencore me ISBN, studentët do të kenë mundësi të publikojnë. <i>Deri tani asnjë student nuk ka publikuar.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në RVB, thuhet se IAL ka një fond prej 75000 euro për të nxitur stafin të kryej punë kërkimore shkencore dhe të botojë në revista me factor impakti si Thomson, Reuters / Clarivate Analytics dhe Scopus. Tashmë që departamenti ka revistën e tij shkencore me ISBN, stafi do të kenë mundësi të publikojnë. <i>Gjatë vizitës u kërkua lista e publikimeve të stafit në parallel me lëndës që ofron. Ky document nuk na u vu në dispozicion nga IAL.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative që ndihmojnë në ritjen e tyre profesionale.</p>

<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p><i>Infrastruktura laboratorike paraqet mangësi. Institucioni dhe programi i studimit rekomandohet të risë kapacitetet laboratorike dhe ta këtë një nga prioritetet kryesore. Mungesa e laboratorëve të testimit të materialeve, të testimit të elementëve konstruktiv dhe laboratorët e simulimit, e pengon personelin akademik të ofroj asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës. I vetmi laborator në shfrytëzim nga studentët master është laborator i topografisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet përbashkë</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>IAL ka lidhur marrëveshje partneriteti me 95 institucione homologe brënda dhe jashtë vendit, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. Pjesë e këtyre marrëveshjeve janë edhe institucione të huaja, në kuadër të së cilave departamenti planifikon mobilitet stafi dhe studentësh. Deri tani është vetëm një staf që ka qënë pjesë e mobiliteteve</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Në RVB tema e diplomës master quhet “mini – kërkim”. Të qënurit një master shkencor, output final duhet të jetë kërkim i mirëfilltë shkencor. Në mënyrë që të hapet rruga për ciklin e tretë të studimeve DIA duhet të risë kapacitetet laboratorike dhe stafin e brëndshëm të angazhuar për këtë drejtim. Një lëndë (kërkimi shkencor) është e pamjaftueshme për të vijuar studimet në ciklin e tretë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore (PMK), këto të fundit drejtohen nga senior researchers dhe orientojnë punën kërkimore të junior researchers.</p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>IAL ka lidhur marrëveshje partneriteti me 95 institucione homologe brënda dhe jashtë vendit, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. Pjesë e këtyre marrëveshjeve janë edhe institucione të huaja, në kuadër të së cilave departamenti planifikon mobilitet stafi dhe</p>

	studentësh. Mobilitetet janë të dyanëshme, do të thotë që edhe staf nga institucionet partnere mund të vijë në UET. Përvec kësaj, studiuesit e huaj ftohen si key note në aktivitetet shkencore të organizuara në UET.
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	IAL ka lidhur marrëveshje partneriteti me 95 institucione homologe brënda dhe jashtë vendit, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. Pjesë e këtyre marrëveshjeve janë edhe institucione të huaja, në kuadër të së cilave departamenti planifikon mobilitet studentësh. Deri tani asnjë student i MSH në Inxhnieri Ndërtimi nuk ka qënë pjesë e këtyre shkembimeve
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	IAL ka lidhur marrëveshje partneriteti me 95 institucione homologe brënda dhe jashtë vendit, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. Pjesë e këtyre marrëveshjeve janë edhe institucione të huaja, në kuadër të së cilave departamenti planifikon mobilitet stafi dhe studentësh. Mobilitetet janë të dyanëshme, do të thotë që edhe staf nga institucionet partnere mund të vijë në UET. Përvec kësaj, studiuesit e huaj ftohen si key note në aktivitetet shkencore të organizuara në UET.
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të Institucioni - ve.	Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi informacione më të detajuara lidhur me procedurat dhe njësitë për informimin e studentëve dhe shërbimet për to në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të universiteteve. Në përgjigje të këtij interesimi u informuam se zyra e kujdesit për studentin ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga regjistrimi e deri në diplomim. Gjithsesi informacionet bazë studentët i marrin nga faqja zyrtare e institucionit, e cila është vazhdimisht e përditësuar. Po kështu edhe zyrat përkatëse brenda institucionit informojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët dhe u ofrojnë atyre të gjitha shërbimet e kërkuara.

	Në takimin me studentët, GVJ i pyeti ata se sa të informuar dhe të përkujdesur ndjeheshin gjatë periudhës së studimeve dhe përgjigja e tyre ishte se ndjeheshin vërtet të kënaqur.			
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Edhe për përmbushjen e këtij kriteri, GVJ mësoi, se në Universitetin European të Tiranës është ngritur dhe funksionon infrastruktura e posaçme organizative dhe logjistike për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e këshillimit të karrierës është vazhdimisht në shërbim të studentëve, duke ofruar informacione dhe mundësi punësimi. Ajo ofron asistencë për kryerjen e aplikimeve të ndryshme për punë. Shpeshherë organizohen panairë punësimi, ku studentët kanë mundësi të lirë pjesëmarrjeje. Zyra e karrierës ka krijuar kontakte me kompani të ndryshme të fushës së ndërtimit. Pranë çdo departamenti njëri nga pedagogët luan rolin e këshilluesit të karrierës. Gjatë takimit me këtë zyrë na u tha se: Kanë marrë email-e nga kompani të ndryshme që kerkojnë studentë për ti punësuar. Njoftimi I dërgohet koordinatorit të programit I cili e shpërndan tek studentët. Zyra bën këshillimin dhe për studentët që duan të regjistrohen ne Msc këshilla kryesore është të ndjekin rrugën dhe formimin e marrë në Bsc.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Edhe për përmbushjen e këtij kriteri një rol parësor ka zyra e karrierës. GVJ u informua që kjo zyrë mblidhte, përpunonte dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve të PS MSH në “Inxhinieri Ndërtimi“. Duke qënë se programi i studimit ka vetëm 2 të diplomuar deri tani, është mjaft e lehtë të mblidhet informacioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI NDËRTIMI ME PROFIL “INFRASTRUKTURË TRANSPORTI”

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë, të statutit të institucionit dhe akteve të brendshme rregullatore, Universiteti Europian i Tiranës ka krijuar sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë. Në institucion është ngritur dhe funksionon zyra e standardeve dhe e cilësisë, e cila përqëndrohet në zbatimin me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit të lartë dhe veçanërisht në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet. Nga vizita në IAL dhe takimi me përfaqësuesit e zyrës na u tha që:</p> <p>Zyra ka një plan pune. Mbështetet në tre shtylla.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Monitorimi I syllabuseve dhe sa I zbatueshëm është 2. Raporti I Focus Grupeve 3. Përpunimi I rezultateve të pyetësorëve të studentëve <p>Në lidhje me vlerësimin e lëndëve dhe përfshirjen e NJBSC na u tha se syllabusi firmoset nga pedagogu i grup lëndës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë (KSBC). 2. Bordi i tregut të punës (BTP). 3. Zyra e standardeve dhe e cilësisë (ZSC). <p>KSBC vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore në Universitetin Europian të Tiranës. BTP shërben si organizëm këshillues në drejtim të ruajtjes e përmirësimit të cilësisë. ZSC zhvillon politikat, strategjitë, proceset dhe udhëzimet në funksion të rritjes së cilësisë në institucion. Kjo zyrë kontrollon edhe zbatueshmërinë e tyre nga njësitë akademike dhe administrative.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i</p>	<p>Institucioni përfshin në procesin e sigurimit të cilësisë personelin akademik, si edhe studentët. Gjithashtu ai këshillohet me BTP, etj. Vlerësime periodike në Universitetin Europian të Tiranës</p>

Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	janë bërë nga organizma jashtë institucionit në kuadrin e akreditimeve të ndryshme, institucionale dhe të programeve të studimit, duke marrë vlerësimet përkatëse.			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	Universiteti ka hartuar politikën e cilësisë dhe politikën për përmirësimin e programeve të studimit. Kjo politikë synon të sigurojë dhe të përmirësojë cilësinë e programeve të studimit, si dhe për të krijuar një kulturë të cilësisë në nivelin institucional.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Departamenti është njësia bazë përgjegjëse për mirëfunksionimin e programit të studimit dhe për të siguruar cilësinë e tij. Monitorimi dhe rishikimi i programeve të studimit kryhet nga departamentet përkatëse. Zyra e standardeve dhe cilësisë kontrollon nga pikëpamja teknike sillabuset e lëndëve, kurse departamenti kontrollon përmbajtjen e tyre. Kjo zyrë ka një kryetare dhe anëtarë nga të gjithë fakultetet. Edhe mendimi i studentëve tërhiqet për rishikimin e programeve të studimit. BTP ofron kontribut të rëndësishëm pasi qartëson kërkesat që vijnë nga kompanitë e fushës.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Institucioni, nëpërmjet ZSC, përgatit një raport mbi vlerësimet e silabuseve në rang departamenti, fakulteti dhe universiteti, i cili i bëhet i njohur personelit akademik.

Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Për çdo vit akademik KSBC monitoron dhe vlerëson secilin nga proceset akademik, duke përgatitur raportin përkatës, i cili paraqitet në dekanate e rektorat.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e vlerësimit të cilësisë të programeve të studimit u bëhen të njohur titullarit të lëndës, drejtuesit të departamentit, etj.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet e vlerësimit theksojnë mangësitë e ndeshura. KSBC dhe strukturat e tjera të sigurimit të cilësisë kontrollojnë implementimin e masave për eliminimin e mangësive.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Departamenti është njësi bazë që bën vlerësimin sistematik të programit të studimit. Në nivel institucional vlerësimi kryhet nga KSBC dhe shtrihet në të gjitha programet e studimit. Secili nga departamentet evidenton problemet që lidhen me programet specifike, të cilat bëjnë pjesë në vetëvlerësimin e vlefshëm për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, Institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Metodat dhe instrumentet e përdorur nga Universiteti European i Tiranës përfshijnë monitorimin e elementëve të lidhur me provimet, silabuset, etj. Për thithjen e mendimit të studentëve përdoren pyetësorë anonimë online, focus grupe, mbledhjet e hapura te DIA, etj.

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Metodat e përdorura nga Institucioni konsistojnë në teste të standardizuara, dëgjime në auditor, vlerësime me pikë, vlerësimi i detyrave të kryera nga studenti, etj.</p> <p>Drejtuksi i departamentit, apo dekani, kontrollojnë direkt mbarëvajtjen dhe cilësinë e zhvillimit të një ore mësimi, duke hartuar një raport vlerësimi përkatës. Për stafin akademik Lektor dhe asistent lector zhvillohen dhe vizita nga eprori.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>	<p>Metodat e tërthorta të zbatuara konsistojnë në sondazhe të ndryshme me studentët, vlerësim i didaktikës, intervista, etj. Të dhënat e përftuara shërbejnë për vlerësimin e performancës së çdo pedagogu. Në raste ekstreme, kur performanca e pedagogut është gjetur jo në nivelin e duhur, atij nuk i është rinovuar kontrata e bashkëpunimit me Universiteti Europian i Tiranës</p> <p>Nga takimi në IAL me përfaqësuesit e NJBSC na u tha se në lidhje me vlerësimin e stafit ndiqet procedura vijuese.</p> <p>Cdo fund semestri bëhet vlerësimi nga studentët. Vlerësimi nuk është I detyrueshëm dhe kjo sjell një pjesëmarrje të ulët të plotësisimit të pyetësorëve gjë që e kemi si mangësi.</p> <p>Vlerësimi në auditor për pedagogun, I cili bëhet me njoftim paraprak më shumë për të verifikuar pretendimet e studentëve.</p> <p>Vlerësimi I studentit për pedagogun bëhet para provimit dhe rezultati I vlerësimit I jepet pedagogut pas ika mbyllur procesverbalin e provimit.</p> <p>Vlerësimi final I pedagogut nuk del si shumator I vlerësimeve.</p> <p><i>Rekomandohet që vlerësimet e komponentëve të vecantë (Studentët, Eprori, Vetëvlerësimi) të kombinohen në vlerësimin final të stafit duke u specifikuar me përqindje të ndryshme sipas rëndësisë të secilit komponent. Gjithashtu rekomandohet që vlerësimi nga studentët dhe nga stafi të jetë</i></p>

	<i>obligativ. Në kuadër të vlerësimit 360 gradë, GVJ rekomandon shtimin e vlerësimit nga kolegu.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i strukturës dhe dokumentacionit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, u konstatua se Institucioni ka ngritur mekanizmat e mjaftueshme, me përfaqësues anëtarësh të brendshëm dhe të jashtëm. Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë (KSBC) është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga senati akademik. KSBC përbëhet nga anëtarë, mes të cilëve një kryetar, nga personeli akademik me kohë të plotë nga çdo njësi kryesore, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik apo administrative, një përfaqësues i studentëve, si dhe një Specialist i jashtëm me përvojë në çështjet e sigurimit të cilësisë. Anëtarët zgjidhen nga senati akademik.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në aktet rregullatore të Universitetit European të Tiranës përcaktohen detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë. Gjithsesi edhe drejtuesit e departamenteve, zyra e karrierës, sekretaria, etj., kanë detyra konkrete për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë. Koordinimin e të gjithë aktorëve e luan KSBC.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Përbërja dhe funksionimi i KSBC siguron përfshirjen e njësisë kryesore dhe bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë të programeve të studimit. Departamenti, si njësi bazë, është përgjegjëse për mirë funksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Konstatohet se personeli akademik e administrativ, si dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të	Senati akademik i universitetit është struktura që vlerëson, garanton dhe është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në

respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	institucion, në përputhje me integritetin akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	KSBC është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga senati akademik. KSBC përbëhet nga kryetari, një pedagog nga çdo fakultet, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademika apo administrative, një përfaqësues nga këshilli i studentëve, si edhe të paktën një ekspert i jashtëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Univeristeti European i Tiranës ka pjesë së strategjisë së tij përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-nxënies, dhe për këtë arsye mbi baza vjetore bëhet vlerësimi i ecurisë së programeve, nëpërmjet shqyrtimit të anketimeve të studentëve, mbarëvajtjes së procesit mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët, sugjerimeve prej pedagogëve të përfshirë në këtë program studimi etj. Zyra së Brendshme e Sigurimit të Cilësisë vlerëson periodikisht efikasitetin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Veprimtarine e saj KSBC e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendarik. Ky plan veprimi është i përvitshëm në të cilin programohen monitorimet në sektorë apo procese që i nënshtrohen vlerësimit që shoqërohen me raporte të detajuara.</p> <p>Nga këto kontrole hartohen raporte, janë prodhuar vlerësime, janë nxjerr rekomandime dhe janë lënë detyra për rregullsinë e procesit mësimor, si dhe janë propozuar masa për ndryshime apo korrigjime për raste ose çështje konkrete.</p>

	<p>Informacioni i nevojshëm është përfshirë në raportin e vetë-vlerësimit të institucionit i cili bëhet publik dhe dërgohet në ministrinë përkatëse.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit janë përdorur metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, ndjekja e ecurisë së studenteve, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Raportet i shpërndahen drejtuesve, ndërsa në departamente diskutohen vetëm ato pjesë të raporteve, që lidhen direkt me veprimtarinë e asaj njësie bazë. Në raste specifike, që kanë ndjeshmëri të lartë, rastet trajtohen nga strukturat drejtuese me personin në takime individuale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për analizimin e situates dhe për identifikimin e problemeve. Të dhënat e përpunuara për çdo pedagog i vihen në dispozicion drejtuesve të Universitetit Europian të Tiranës. Në varësi të natyrë së problemit merren masat përkatëse, duke filluar nga trainimi e deri tek ndërprerja e bashkëpunimit.</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të cilësisë mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - trajnime të vazhdueshme të fokusuara në aspekte didaktike të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor - Nxitja e stafit akademik për pjesëmarrje në aktivitete shkencore - bashkëpunimi ndërkombëtar dhe pjesëmarrja e stafit në projekte Erasmus+
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit nëpërmje kontrollit të kryqëzuar që kryhet nga struktura të ndryshme brenda Universiteti Europian i Tiranës, duke filluar nga departamentet e deri te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, ZSC, KSBC, etj. <i>Rekomandohet që vlerësimet e komponentëve të vecantë (Studentët, Epërori, Vetëvlerësimi) të kombinohen në vlerësimin final të stafit duke u specifikuar me përqindje të ndryshme sipas rëndësisë të secilit komponent. Gjithashtu rekomandohet që vlerësimi nga studentët dhe nga stafi të jetë obligativ. Në kuadër të vlerësimit 360 gradë, GVJ rekomandon shtimin e vlerësimit nga kolegu.</i></p>

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë, në bashkëpunim me fakultetet, organizojnë seanca informimi për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të pedagogut të lëndës për përmirësimin e programit të studimit. Gjithashtu organizohen rregullisht trainime për stafin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profil Infrastrukturë Transporti të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Bashkëpunimi me tregun e punës
2. Informatizimi i sistemeve dhe platformat dixhitale
3. Personel akademik i motivuar.
4. Mbështetje institucionale maksimale për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, e drejtuar kjo tek personeli akademik dhe te studentët.

Pika të dobta

1. Raport shumë i disfavorshëm ndërmjet stafit efektiv dhe atij me kontratë. PAE/PAK – 3/7.
2. Kurrikula e programit të studimit është shumë e përgjithshme. Të qënurit master shkencor me profil Infrastrukturë Transporti kërkon një kurrikul shumë më të dedikuar për programin e studimit.
3. Mungesa e laboratorëve të dedikuar për inxhinierinë e ndërtimit, ku të kryhen prova apo teste, që lidhen me lëndë specifike bazë për formimin inxhinierik, si gjeoteknikë, materiale ndërtimi, struktura betonarme, etj. Në laboratorin ekzistues, i cili në fakt është pjesë e Kolegjit Profesional, por që shfrytëzohet edhe nga UET, kryhen vetëm dy prova, që nuk i shërbejnë programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me profil Infrastrukturë.
4. Praktikat mësimore të studentëve janë formale dhe jo të frutshme. Pjesërisht kjo justifikohet edhe me situatën e jashtëzakonshme për shkak të pandemisë.
5. Në kurrikulat e programeve të studimit mungojnë lëndët me zgjedhje.
6. Mungesa e një programi kompiuterik (softëare), që mund të përdoret nga studentët e inxhinierisë së ndërtimit, për kryerjen e detyrave apo projekteve të lëndëve.
7. Nuk janë vendosur kritere të qarta për pranimin e studentëve në programin e studimit Master. Kjo ka sjellë si pasojë pranimin në programin e studimit Master, të studentëve, të cilët nuk kanë njohuritë e nevojshme për të ndjekur këtë program studimi.
8. Mungesë bashkëpunimesh ndërkombëtare për programin e studimit. Kjo sjellë mungesë mobiliteti dhe shkëmbimi për stafin dhe studentët
9. Mungesë e titujsh bashkëkohorë në bibliotekën e IAL dhe gjithashtu të reflektuar këto në sylabuset e programit të studimit
10. Për llogaritjen e ngarkesës mësimore të personelit akademik përdoren koeficientë të ndryshëm ekuivalentimi. Në disa raste përdoren koeficientë më të vegjël se 1, psh. 0.75.

Kjo do të thotë, në këto raste, se personelit akademik nuk i llogaritet si ngarkesë mësimore 25% e orëve faktike, që ai zhvillon në auditor.

11. Statuti i institucionit është miratuar në vitin 2017. Programi i studimit Master në Inxhinieri Ndërtimi është çelur në vitin akademik 2018 – 2019. Në statut nuk janë reflektuar ndryshimet strukturore që kanë ndodhur në UET.
12. Vihen re mangësi në dosjet e personelit akademik me kontratë (PAK).
13. Vihen re mangësi dhe pasaktësi në punën e sekretarisë.

Rekomandime

1. Të rishikohet kurrikula e programit të studimit në raport me lëndët, orët, ngarkesën dhe peshën specifike të cdo lënde në raport me profiling e Infrastrukturës së Transportit. Më specifikisht: a) Rekomandohet shpërndarja uniforme e krediteve ne dy vitet akademike; b) Rekomandohet shtimi i lëndëve të menaxhimit të ndërtimit dhe i lëndëve të dedikuara për testimin e materialeve ndërtimore në mënyrë që studentët të jenë më atraktiv për tregune punës. ; c) Rekomandohet shtimi i lëndëve të profilit dhe reduktimi i orëve dhe krediteve të lëndëve si Aplikime të avancuara të fizikës teknike, konstruksione Special e beton arme, restaurim dhe përforcim i strukturave; d) Rekomandohet shtimi i lëndëve zgjedhore ne kurrikulën e programit. Disa prej lëndëve të sipërpëmendura mund të jenë pjesë e grup lëndëve me zgjedhje; e) Rekomandohet shtimi i Dinamika e dherave duke qënë se disa prej problemeve në urat e sipërpërmenduara ka ardhur si rezultat i cedimit të dherave nga tërmeti në këmbët e urave; f) Rekomandohet shtimi i të paktën 2 lëndëve zgjedhore. Në kurrikul ekziston një lëndë nën kategorinë D “Honors Course”, rekomandohet që kësaj lënde ti jepet karrakter zgjedhor dhe gjithashtu lënda në vetëvete të specifikohet; g) GVJ rekomandon që ose duhet krijuar një kategori e tretë për lëndët e inxhnierisë së ndërtimit, ose të mos specifikohen fare. Duke i lënë më shumë liri profesorit në mënyrën e ogranizimit të lëndës, programi i studimit dhe studentët do të përfitojnë më shumë.
2. Rekomandohet që Institucioni të ris bashkëpunimet ndërkombëtare për fushën specifike, të ris kapacitetet fizike në drejtim të kërkimit të aplikuar shkencor (laboratore) dhe të detajoj më shumë kurrikulën e studimit. Rekomandohet që Departamenti i Arkitekturës

- dhe Inxhnierisë, më specifikisht programii studimit MSH në Inxhnieri Ndërtimi, të përfshihet më shumë në planin e projekteve ndërkombëtare të Institucionit.
3. Rekomandohet që në planin strategjik të institucionit në pikën 2 “Prioritetet e kërkimit shkencor”, të shtohen si fusha të kërkimit shkencor edhe inxhinieria e ndërtimit
 4. Rekomandohet që të rriten bashkëpunimet me insitucione homologe në vende të tjera që kanë programe të ngjashme studimi, në mënyrë që programi i studimit të përfitoj nga ndërkombëtarizimi dhe të rritet mobiliteti i stafit dhe studentëve.
 5. Rekomandohet të organizohen më mirë dhe të bëhen vertet të efektshme praktikatat mësimore të studentëve.
 6. Rekomandohet të vendosen kritere të qarta dhe filtruese për shmangien e pranimit në programin Master të studentëve, që nuk kanë kryer studimet Bachelor në programe të afërta me inxhinierinë e ndërtimit. Rekomandohet që studentët që regjistrohen në master, nëse nuk vijnë me një bachelor të fushave të inxhnierisë së ndërtimit, të ndjekin lëndë në bachelor përpara se të hyjnë dhe të ndjekin lëndë në master. Nëse nuk kryehet ky proces, kjo kthehet në pengesë edhe për profesorin i cili duhet të shpjegoj bazat (të cilat zhvillohen ne BSc) në mënyrë që nëse del koha të shpjegoj teoritë e avancuara. Zyra e studentëve apo e këshillimit duhet të punojë në këtë drejtim që ti orientoj studentët të thellohen në studime master në fusha të ngjashme me ato të bachelor.
 7. GVJ rekomandon përfshirjen më të madhe të studentëve në aktivitete të institucionit. Angazhimi i studentëve të programit master ishte minimal edhe gjatë vizitës që GVJ kreu në institucion, ata nuk u paraqitën në takimin e paracaktuar. Rekomandohet që institucioni të rishikoj mundësinë që studentët të jenë në shkollë gjatë orëve normale të punës, ose të shtunën, që të kenë mundësi të jenë pjesë e aktiviteteve, të aksesojnë shërbimet e ofruara si biblioteka, laboratore, etj.
 8. Të ngrihen laboratorët e dedikuar për inxhinierinë e ndërtimit.
 9. Të përditësohet statuti, i cili të reflektojë ndryshimet strukturore të ndodhura në UET.
 10. Të shmanget angazhimi në mësimdhënie në programin Master, i personelit akademik, që nuk ka të paktën gradën shkencore Doktor.
 11. Të plotësohen dosjet e personelit akademik me kontratë (PAK).
 12. Të shmangen korigjimet në regjistrat themelore të institucionit, nga ana e personelit të sekretarisë.

13. Rekomandohet shtimi i ndërveprimit me tregun e punës nëpërmjet leksioneve të hapura nga përfaqësues të industrisë.
14. Të kushtohet më shumë vëmëndje në procesin e diplomimit lidhur me cilësinë e temave të diplomave dhe procedurave të dorëzimit të tyre.
15. Të pasurohet biblioteka fizike dhe elektronike.
16. Stafi akademik titular i lëndës duhet të jetë ekspert i fushës përkatëse, dhe tregues i matshëm i kësaj pike janë publikimet.
17. Të mundësohet përdorimi i një programi kompiuterik (softëare) modelimi inxhnierik nga studentët.
18. Të shikohet mundësia e lehtësimit të ngarkesës së personelit akademik, pasi pedagogët kanë vështirësi në gjetjen e kohës së nevojshme për veprimtari shkencore dhe për promovimin e tyre akademik e shkencor.
19. Rekomandohet që vlerësimet e komponentëve të vecantë (Studentët, Epërori, Vetëvlerësimi) të kombinohen në vlerësimin final të stafit duke u specifikuar me përqindje të ndryshme sipas rëndësisë të secilit komponent. Gjithashtu rekomandohet që vlerësimi nga studentët dhe nga stafi të jetë obligativ. Në kuadër të vlerëimit 360 gradë, GVJ rekomandon shtimin e vlerëimit nga kolegu.

Conclusions of the evaluation for the study program of the second cycle Master of Science in Civil Engineering specialization in Infrastructure Engineering (Transportation) of the Higher Education Institution "European University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. Cooperation with the labor market
2. Systems and platforms digitalization
3. Motivated academic staff.
4. Maximum institutional support for the smooth running of the teaching and learning process, directed at the academic staff and students.

Weaknesses

1. Very unfavorable ratio between effective and contract staff.

2. The curriculum of the study program is very general. Being a Master of Science in Infrastructure Engineering (Transportation), requires a much more dedicated curriculum for the study program.
3. Lack of dedicated laboratories for civil engineering, where tests are performed, related to specific courses, such as geotechnics, construction materials, reinforced concrete structures, etc. In the existing laboratory, which is actually part of the Vocational College, but which is used by UET, only two tests are performed, which do not serve the program of the Master of Science in Infrastructure Engineering (Transportation)
4. Professional practices are formal and not fruitful. This is partly justified by the emergency situation due to the pandemic.
5. Elective courses are missing in the curricula of study programs.
6. Lack of civil engineering software designs, which can be used by civil engineering students, to perform assignments or course projects.
7. Lack of international cooperation for the study program. This leads to a lack of mobility and exchange for staff and students
8. There are no clear criteria for admission of students to the Master study program. This has resulted in the admission of students who do not have the basic necessary knowledge to attend this study program.
9. Lack of contemporary titles in the HEI library is also reflected in the syllabi of the study programme.
10. Different equivalence coefficients are used to calculate the teaching load of academic staff. In some cases coefficients smaller than 1 are used, e.g. 0.75. This means that the academic staff is not counted as teaching load 25% of the actual hours that he conducts in the auditorium.
11. The statute of the institution was approved in 2017. The Master study program in Civil Engineering was opened in the academic year 2018 - 2019. The statute does not reflect the structural changes that have occurred at UET.
12. Shortcomings are noted in the files of contract academic staff (CASs).
13. Deficiencies and inaccuracies in the work of the students records office are noticed.

Recommendations

1. To review the curriculum of the study program in relation to the subjects/classes, hours, load and specific weight of each subject in relation to the profile of the study programme. More specifically: a) It is recommended the uniform distribution of credits in the two academic years; b) It is recommended to add construction management courses and courses dedicated to testing construction materials so that students are more attractive for work

shows. ; c) It is recommended to increase the specialization courses and reduce the hours and credits of courses such as Advanced Applications of Technical Physics, Special constructions and reinforced concrete, restoration and reinforcement of structures; d) It is recommended to add elective courses to the program curriculum. Some of the above courses may be part of a group of elective courses; e) It is recommended to add "Soil Dynamics" as some of the problems in the above-mentioned bridges have come as a result of soil differential movement to the bridges footing due to earthquake; f) It is recommended to add at least 2 elective courses. There is a course under category D "Honors Course" in the curriculum; it is recommended that this course be given an elective character and also that the course itself be specified; g) External Evaluation Group recommends that either a third category should be created for civil engineering subjects, or not specified at all, in regard to course assessments. By leaving more freedom to the professor in the way the course is organized, the study program and the students will benefit more.

2. It is recommended that the Institution renew international cooperation for the specific field, increase physical capacity in terms of applied scientific research (laboratories) and further detail the study curriculum. It is recommended that the Department of Architecture and Engineering, more specifically the MSc study program in Civil Engineering, to be included in the international project plan of the Institution.
3. It is recommended that in the strategic plan of the institution in point 2 "Scientific research priorities", to be added also scientific research in civil engineering.
4. It is recommended to increase cooperation with counterpart institutions in other countries that have similar study programs, so that the study program takes advantage of internationalization and increases staff and student mobility.
5. It is recommended to better organize and make professional practices really effective.
6. It is recommended to set clear and filtering criteria to avoid admission to the Master program of students who have not completed Bachelor studies in programs close to civil engineering. It is recommended that students enrolling in the master, if they do not come with a bachelor of civil engineering fields, pursue bachelor courses before entering and pursuing master courses. If this process is not performed, it becomes an obstacle for the professor who has to explain the basics of civil engineering. The student or counseling office should work in this direction to orient students to deepen in master studies in areas similar to those of the bachelor.

7. The External Evaluation Group recommends greater involvement of students in the activities of the institution. The engagement of the master program students was minimal even during the visit that EEG made to the institution; they did not show up at the scheduled meeting. It is recommended that the institution review the possibility for students to be in school during normal working hours, or on Saturdays, to have the opportunity to be part of activities, to access the services provided such as libraries, laboratories, etc.
8. Establish laboratories dedicated to civil engineering.
9. Update the statute, which reflects the structural changes that have occurred at UET.
10. Avoid engaging in teaching processes in the Master program, of academic staff, who do not have at least the scientific degree of Doctor.
11. Complete the files of the contracted academic staff (CAS).
12. Avoid corrections in the basic registers of the institution, by the records office staff.
13. It is recommended to increase the interaction with the labor market through open lectures by industry representatives.
14. Pay more attention in the graduation process regarding the quality of the diploma topics and the procedures for their submission.
15. Enrich the physical and electronic library.
16. Academic staff of the course should be experts in the relevant field, and measurable indicators of this point are publications.
17. To enable the use of a computer program (software) engineering modeling by students.
18. Consider the possibility of easing the workload of academic staff, as professors have difficulty finding the needed time for scientific activities and for their academic and scientific promotion.
19. It is recommended that the evaluations of specific components (Students, Superior, Self-evaluation) be combined in the final evaluation of the staff being specified with different percentages according to the importance of each component. It is also recommended that assessment by students and staff be mandatory. In the context of 360-degree evaluation, GVJ recommends increasing the evaluation by the colleague.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			✓	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			✓	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			✓	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
VLERËSIMI TËRËSOR			✓	